

## INTERVISTË ME ZEQRIRJA BALLATËN

Prishtinë | Data: 26 janar dhe 9 shtator 2017

Kohëzgjatja: 160 minuta

Të pranishëm:

1. Zeqirja Ballata (I intervistuari)
2. Petrit Çeku (Intervistuesi)
3. Donjetë Berisha (Kamera)

*Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:*

*() - komunikim emocional*

*{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste*

*Simbole të tjera në transkriptë:*

*[ ] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin*

*Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.*

## **Pjesa e Parë**

*[Kjo pjesë e intervistës është realizuar me 9 shtator, 2017]*

**Zeqirja Ballata:** Jom Zeqirja Ballata, i lindur në Gjakovë me 1943. Pastaj i shkolluar në të gjitha nivelet. Dhe si pedagog poashtu në të gjitha nivelet. Tani jom në pension.

**Petrit Çeku:** A na tregoni pak për fëmijërinë në Gjakovë?

**Zeqirja Ballata:** Po. Fëmijërija, siç e dijmë të gjithë... ka qenë e lidhur si gjithkund në familje, të lidhur me, me familjen. Por një karakteristikë ka qenë që nga fëmijërija e hershme... se prindërit kanë kënduar, po. Dhe kanë kënduar baba sidomos dhe me dy vllëzërit e tij. Kurse ka kënduar dhe gjyshi... bile për më tepër ka vdekë i ri, mjaft i ri edhe i ka lanë fmitë e vegjël. Po, pesë fmi edhe një vajzë. Pra, që nga gjyshi osht' përcjellë te djemtë, pra te babi im dhe axhallarët. Kanë këndu për qef në shtëpi, në mramje. Ndonjihere edhe të dieleve paradite, po... Edhe...

**Petrit Çeku:** Si fëmijë...

**Zeqirja Ballata:** Edhe... po fillimisht pra, fare i vogël sa isha unë, vllau ma i madh, ai pat filluar defit me i ra. Pastaj kaloi në prim, primi {shpejgon me dorë} po, edhe n'braq, dhe më vonë në kitarë. Ishte '34 i lindur, pastaj ka studiuar kështu, ka qenë inxhinier tekstili. Po ka qenë aktivist, po, si kitarist dhe... Pra me këto shoqërimi të vllaut... Pastaj une sa isha në shkollë t'mesme edhe me fizarmonikë, kohë mbas kohe. Për arsye se kanë kënduar kangë të vjetra, në shumicën e rasteve kangë të vjetra që njiheshin, njihen edhe tash pjesërisht. Tash pakëz kanë nisur të harrohen sepse kanë dalur kangë të tjera. Në mjaft raste edhe jo me ndonjë porosi, apo jo?

Po kangë që, edhe të kohës së pushtimit osman, për shembull një varg nga ajo është, "Hypa n'kajtkë e rashë n'det, erdh një shqiptar më gjet". E pastaj vargjet e tjera. Dhe një nga ato vargje... edhe, po, "Ikën shkojëzit e më lanë..."

**Petrit Çeku:** Çfarë... po...

**Zeqirja Ballata:** {ngritë dorën që të pres pak} Kërkoj falje.

**Petrit Çeku:** Po, patjetër.

**Donjetë Berisha:** A don të ndalemi pak?

**Petrit Çeku:** Jo, s'ka nevojë...

**Zeqirja Ballata:** Jo, kalon tash, po (qeshë)...

**Petrit Çeku:** Faktikisht shumë, shumë...

**Zeqirja Ballata:** E kështu... Desha, desha të them që domethanë, kanë qenë mjaft t'vjetra sepse kta kanë këndu edhe në teqe...

**Petrit Çeku:** Dhe kjo është...

**Zeqirja Ballata:** Eh, babi im ka qenë solist n'teqe, me Musa Pejën. Të dy kanë Musaja. Musa Peja ishte baba i Ismet Pejës. Po ai ka qenë pak ma i dobët kështu {prekë fytyrën}, edhe n'trup kështu. Ka pasë za shumë t'mirë po jo aq t'fuqishëm. Baba im ka qenë pakëz më i madh, kështu.... Dhe kanë qenë dy solist atje. Edhe thojshin, "Dy Musajat janë bylbylat e teqës". Kështu thojshin atëhere, po, thuhej. Dhe, dhe thuj, po them thuhej, kjo nuk është trillim... Por, në teqe, siç mund të dihet, në rastin e aty... festave që mbahen, po, të dervishëve pra, po, të tyre... tarikateve të ndryshme, apo jo? Ato jonë organizu herët n'mëngjes, domethanë para se me lindë, si t'thushë, drita. Dhe në qytete, pse edhe n'katunde, po n'katunde o pak ma vshtirë se mund t'jenë ma rrallë, po n' qytete që jonë shtëpiat afër, domethanë osht' qetë herët. Dhe sado që ka qenë teqja larg, po, pra prej një ane në anën tjetër {tregon me duar} osht' ndigju ajo, po.

Është e natyrshme sa u ndëgju për arsye se ka qenë, domethanë qyteti ende n'gjumë. Edhe në teqe pak a shumë më t'vjetra, ma t'mëdha, e kjo ka qenë, po... osht' edhe tash jonë bo disa aty, jonë nda e ku di une.... Po ajo kryesorja që osht' edhe tash, po, me një platformë shumë t'lartë {shiqon lartë} po, shumë kumbuese. Pastaj kanë qenë edhe aty dy djem t'ri që i bishin, siç i çuajnë ata, kuduma, domethanë osht' si, po, si një lloj... një lloj lodre e vogël, po në lëkurë, po ni çanak, po, me lëkurë {tregon me duar} edhe në ni rryp {kërset me gishta në dorë} kështu... Që i bintë lëkurës...

**Petrit Çeku:** Me rryp?

**Zeqirja Ballata:** Po, me rryp. Por se... tingëllon ajo, e jep një kumbim, po, e kështu... Domethanë ajo osht' ndigju pastaj, se ajo u kry pastaj kur ka kenë ora, tetë e nantë e dhjetë kur jonë... e po... Por thuhej se... Kurse, kuse në shtëpi... po gjithashtu thuhej që kur këndonin, se ka pasë raste kur vinin edhe ndonji mik e shokë e kështu, këndohej edhe pihej, pihej. Po lëviznin nëpër rafte {tregon me duar} që kanë qenë raftet nëpër sobat e mëdha, po, sobat e burrave ose t'nejës e kështu {tregon me duar} lëvizte, po, (qeshë) e kështu... E pra... E pra kjo ka qenë një fëmini, e lidhur... dhe ne mblidheshim kështu vllazënit, po, katër vllazën, po, një motër e aty natyrisht... po...

**Petrit Çeku:** Çfarë i kishit prindërit me profesion?

**Zeqirja Ballata:** Po, po kanë qenë zanatli... Kanë qenë, katër kanë qenë, po një ka vdekë i ri krejtësisht, domethanë një nga axhat, apo jo? Mandej ka vdekë edhe ni tjetër, pastaj kanë ngelë dy, po... Që e kemi përjetu edhe me djalin e axhës, Selim e ka emrin djali i axhës, ka qenë n'shollë t'mesme ktu ka dhanë msim, tash n'pension edhe ai. Të dy kanë këndu... E kështu, domethanë kjo osht'. Mandej kjo ka qenë një nxitje, po edhe përmes vllaut si më i vjetër, domethanë me, me shku në shkollë t'muzikës. Edhe unë kom qenë në shkollë t'muzikës në Prizren. Atje kishte pak probleme tek gjuha...

**Petrit Çeku:** Në çfarë moshe filluat shkollën e muzikës, domethanë, në Prizren?

**Zeqirja Ballata:** Po, po katërmbëdhjetë vjeçare...

**Petrit Çeku:** Domethanë shkolla e mesme...

**Zeqirja Ballata:** Shkolla e mesme, po, kom fillu, po... apo 15 vjeçare ndoshta...

**Petrit Çeku:** Po, ashtu, nëse, pas tetë viteve...

**Zeqirja Ballata:** Eh, po... e kështu, domethanë ka pasë pak probleme, gjuha, kështu... Ka qenë një profesor, bile edhe drejtor pastaj që dirigjonte ai korin, po. Po ka qenë mjaft i ashpër kështu, jo bash i popullarizuar te nxanësit përgjithësisht. Po edhe jo ndoni muziktar i njohur si dirigjent korit një kohë, po ishte dhe drejtor domethanë kështu që... Ishe edhe një problem sa i përket gjuhës serbo-kroate atëhere, te gjithë thoshin po... po, po shkolla e mesme, kom pasë fatin që kom pasë një pianiste profesoreshë, po e përmendi atë se kanë qenë plotë profesor, po, natyrisht të tjerë. Po duhet të ndalem se ajo pianistja ishte një profesoreshë e vjetër, e ardhur nga, nga Vërshac quhet ai qyteti, osht' bash mes Vojvodinës dhe Serbisë, po. Tokin Desanka, Tokin Desanka, po...

**Petrit Çeku:** Tokin...

**Zeqirja Ballata:** Po, po mbiemrin Tokin Desanka. Po, po ishte një përzirje domethanë jo ni serbe, as hungareze jo, kështu simbas emrit e mbiemrit, por e vjetër, me sheshir {tregon me duar}, po. Dhe kur dilnim kështu, se shumicën e rasteve kisha unë ndër ato orët e fundit me të, kur ajo mbaronte. Bile kishte edhe kështu {tregon me duar} dhe nxerrte ndonjëherë ndonjë sheqer a ndojë llokum (qeshë) apo... ose kur dilnim përjashta që zbritnim teposhtë ka qenë, partizani quhej atëhere ajo, se di a e din ti, a jo [i drejtohet intervistuesit], ajo ndërtesa ka qenë ku ushtronim ne atëhere. Osht' karshi kishës {tregon me duar}, domethanë hypim naltë, kisha o ktu {tregon me duar} karshi kishën osht' ni ndërtesë që partizanër i kanë varret...

**Petrit Çeku:** Po...

**Zeqirja Ballata:** Ajo ndërtesë, dhe aty ushtronim ne, po. Edhe kur zbritnim teposhtë, ato që kanë qenë ëmbëltoret, andej {tregon me duar} e këndej e... Edhe hynim brenda, se ajo printe, edhe thonte, "Da li se gospdin slaže..." Qeshtu thonte atëhere, atëhere s'kishe *gospodin*, kishte *drug* ose kështu (qeshë)... se nxanësit po i... po ashtu thonte ajo. Edhe disa herë kemi marrë pjesë me duo pianistike. Ose në katër durë, po, ajo dhe unë. Disa pjesë kështu, po... Kështu desha t'them se kjo ka qenë shumë nxitëse,

dhe qysh atëherë unë kom ba një, disa komponime që pastaj i kam hudhë, kështu, pak a shumë që... Ta kujtonin Chopin ose Liszt e kështu... Pastaj i kom hudhë une ato, i kom ndalë disa, po, sa për t'konkuruar në Lublanë, po, diçka për piano, diçka për violinë për një kroat që ka qenë inxhinier. Vinte ai te vllau im verës dhe, mysafir vinte dhe me violinë {tregon me duar} e kom pasë kompozu për të, për vilonë solo, po. Bile ajo ka ngelë te ai se kom une atë partiturë po (qeshë)... Nejse...

**Petrit Çeku:** E çfarë qasje, a keni pasë qasje në muzikë n'atë botë? Gjatë viteve t'shollës t'mesme...

**Zeqirja Ballata:** Po...

**Petrit Çeku:** Domethonë a keni pasë...

**Zeqirja Ballata:** Po, po...

**Petrit Çeku:** Edhe nëpër shkolla?

**Zeqirja Ballata:** Po. Edhe në shtëpi radion e dëgjojmë Tiranën, Gjakova e ndëgjonte shumë lehtë. Pastaj Prizreni gjithashtu, Peja... Domethanë, po Gjakova e ndëgjonte mirë, po natyrisht duhej të ruheshe se ka pasë raste kur vinon policët, po.

**Petrit Çeku:** E cila muzikë ju impresionojke ma së shumti? Çfarë përshtypje keni pasë? Cilët kompozitorë i keni...

**Zeqirja Ballata:** Po, si nuanës, si nuanës atëhere, natyrisht na tërhiqnin këngët. Këngët, qofshin popullore, sidomos kto, domethanë t'veriut që është me qendër në Shkodër, po edhe ato të lehta. Vllau im i dëgjontë ditë e natë, po (qeshë) sa herë që ishte i lirë, ka pasë prirje ma shumë për muzikën e lehtë. Dhe ka qenë aktiv në Shoqërinë kulturo-artistike në Gjakovë, "Ardian Dushi" e kështu me rradhë, po. Bile ka lonë një disk të, të inçizuar të kangëve t'tij, po, që ia kanë inçizu, po, e kështu. Domethanë kjo osht', po, atëhere ishte një nxitje edhe për ndonji grupim që kishte, jo vetëm në Gjakovë edhe n'vende tjera. Po në Gjakovë kishte, dhe ishin domethanë shumë të... si t'thushë, të... që i kapnin formën e këndimit edhe përcjelljen. Prandaj shpesh herë thuhej atje që, domethanë, ma mirë po i bin kangëve, po përcjellin kangët shqipe, domethanë të Tiranës e kështu me rradhë.... Se sa ansambli popullor që ishte në radio, ashtu thuhej atëhere. Po edhe shpesh herë vinin ata inçizonin, kështu...

E kështu, domethanë ajo ishte një vazhdimësi e asaj çka une dëgjoja me vllazënit në shtëpi kështu. Po, kanga ishte e pranishme gjithnji, po. Kangët, domethanë se ato edhe tash thuhën, thuhën nëpër katunde se nëpër katunde kanë ngelë ato pak. Tek qytetarët ajo gati ajo gati e harruar kështu, n'kuptimin e këngëve t'vjetra që thuhej, ku flitej për, për besnikërinë e shokëve e kështu... Për, për sjelljen, për nderin, për, po... Prandaj aty përmendet "shokëzitet" jo "shokët", po "shokëzitet" domethanë {tregon me dorë} jo shokë, pra. Eh n'atë kuptim, "Ikën shokëzitet dhe me lanë në breg të Uzdrumit". Pastaj unë jom interesu e qenka një, një, një skele Yzdyrum atje...

**Petrit Çeku:** Atje në Turqi?

**Zeqirja Ballata:** Në Turqi, po, eh. Domethanë kjo këngë në kohën e Turqisë, ku kanë lë... eh, eh. Natyrisht se kta që kanë hypë n'kajkë, po (qeshë) kane qenë... Edhe ktu ka qenë vshtirë se të duhej me shku ne Ulqin për shembull ose andej në Vlorë, a ku e din në, po. E ka pasë raste t'ndryshme... Ose kur kanë shku ushtarë atëhere ka shtatë vjet, deri në dymbëdhjetë vjet kanë shku ushtarë. Domethanë, mandej ka kangë që s'jonë kthy pastaj, ka, ato, po... Por mund t'ndalemi tash, po kur përshembull ku fliten fjalë, fjali në kangë, i thuhet, e lajmëron se edhe shkrimet kanë qenë... Duhej njeri mbas njeri me i çu, me mrrri mbas disa muajve. Ta zamë në Kosovë, letra që kanë çu edhe njerëz që kanë qenë t'fejuar ata. T'fejuar domethanë le të lirohen, domëthanë te fejuarat sepse kumeditë a vijnë a jo. E kështu, domethanë kangë shumë t'prekshme.

Edhe ne jse nëpër qytete kanë qenë ma t'rralla ato, po ka pasë aty ktu, ku ta di une, si ka ardhë puna deri te vrasjet, ose tradhëtitë, ose... E kështu, po, e kështu. Pra kjo osht' se ndoshta e zgjata, ju [i drejtohet intervistuesit] mund ta shkurtoni, apo jo? Kjo osht' fëminija, ka qenë një fëmini mjaft aktive kështu, e gjallë e kështu n'familje...

**Petrit Çeku:** A ju kujtohet Gjakova pas Luftës së Dytë Botërore?

**Zeqirja Ballata:** Po, po.

**Petrit Çeku:** Si, si osht' dukë kështu...

**Zeqirja Ballata:** Po, Gjakova...

**Petrit Çeku:** Shoqnia n'përgjithsi?

**Zeqirja Ballata:** Po, po. Gjakova, Prizreni si qytet dhe me element kryeqyteti ka qenë më i vjetër, më i madh, natyrisht. Por Gjakova ka qenë mjaft e... si t'thushë kompakte, kompakte. Bilem jo vetëm Gjakova edhe me rrethinën. Domethanë malësia e Gjakovës n'kuptimin pozitiv t'mledhjeve, t'luftave, t'tubimeve, po, që jonë mbajtë mbrenda ose në rrethinë, po. Ka pasë një, një mbështetje ata n'qytet, ata qyteti në fshatrat, po, t'malësisë, po, fiset, kështu të lidhura njëra me... Kështu që ka lujtë një randësi dhe n'këtë drejtim domethanë... Si qyteti ka pasë shumë dyqane, Sami Frashëri e përshkrinë në librin e tij, në një nga librat e... e katër librave që i kemi ne se ai ka edhe të tjera që s'jonë, po... që ndoshta lidhën edhe me çështje të tjera siç dihet, se ka edhe enciklopedinë për shembull, e kështu me radhë...

Po i përmend mullitë, krojet, dyqanet, zanatlitë, zanatlitë... Të gjithë i mbledhë, janë me numra, po, domethanë se ka qenë e ka pytë njerëzit, po... Kaq, kaq... Ku i di une... Rrobaqepës, po, se atëhere i kanë thanë maqinagji, qe, po (qeshë) në Gjakovë kanë thanë maqinagji, rrobaqepës, po... E mandej, ku i di une, këto... Për shembull qyrahaxhi {prek kokën me dorë}, bardhë domethanë... Edhe ma ndej, ku di une, jo farkatar, jo mbathëtar, jo... E zanatet e tjera. Mandej kanë qenë këto tophanet që i themi, po, tophanet ku osht' rexhë lëkura. Për shembull afër erni... afër, *pardon*, krenës ku e kemi pasë ne shtëpinë kanë qenë tophanet. Rastësisht ka qenë, n'ato tophane edhe daja im aty, po. Dhe dijmë që atëhere kanë bo, domethanë kanë lëvizë, po, para Luftës domethanë të Dytë Botërore, po, ajo gjeneratë, atëhere, edhe më përpara... Domethanë në kohën e Turqisë kanë lëvizë, se ishte krejt

Turqia atëhere domethanë, edhe kanë shku në Shqipëri, e në Greqi, e e di une, po. Në Selanik sidomos, osht' përmend shumë herë, e kështu...

Domethanë, kështu që ka qenë qyteti i organizuar, po. Mandej grupe t'caktuara pleqësh e kështu, kanë qenë shumë pozitiv me, domethanë kur ka pasë ngatërresa, ngatërresa, kanë shku, kanë ndihmu me i qetësu, me i afri njerëzit, me i falë njeri-tjerin, po, po. Dhe kjo nuk ka ndodhë vetëm tek shqipëtarët musliman apo katolik, po kanë qenë t'përzier. Përkundrazi ka shku, domethanë s'bashku. Mandej ka pasë raste kur i kanë marrë hoxhë, ose prift, ose hoxhë e prift, po, s'bashku, po. Jo n'qytet aq shumë, ndoshta shumë rrallë, por nëpër katunde përreth, po, kanë shku. Edhe, kështu që ka qenë një shoqëri mjaft e organizuar, zanatet kanë qenë, po. Kroje, plotë kroje se përmes Krojet ai {bënë me dorë sikur shkruan}. Tash s'jonë ato kroje për shembull, po, i përmend mullitë, po.

Kështu ka qenë edhe n'qytetet e tjera, ku më shumë e ku me pak, e kështu. Kështu që ka pasë një organizim në Gjakovë. Mandej ka qenë... Fillimisht ka qenë e pastër, domethanë nuk ka pasë serbo-malazez që pastaj jonë ardhë. I kanë pru në të vërtetë. Ka qenë një rrugë, po, po. Edhe domethanë e ka marrë edhe nga njeriu vendas, katolik atëhere, Jak, Jak Vula. Prandaj Jakova, fusha e Jakut. Mandej e kanë bo kta Gjakovica, në '13. Dej n'fund të '12 kanë qenë, po... '13 pastaj kur kanë aneksu Kosovën e kanë ndërru menjihërë. Pastaj kanë pru edhe serb, e kështu, edhe të tjerë, edhe të tjerë. Veç mos me qenë shqipëtar, për ta përzier popullatën e kështu.

Pra ka pasë shoqëri grupe, grupe. Ka pasë shoqata, shoqata, para Luftës të Dytë Botërore, po. Po që janë mbledhë, janë mbledhë me ren, rene jonë mbledhë, rende jonë qujtë ato deri vonë. "Rendin e ka ky këtë javë", n'fund t'javës ka qenë ajo. "Mas javës e ka ai..." Edhe ka qenë ni përgjegjësi, e ka termin bile turk, termi turk, se s'po m'kujtohet tash, po. Domethanë fjala, se ka plotë fjalë turke tek ne, (qeshë) kështu... Që e ka pasë për përgjegjësi me shiqu rendin dhe... "Këtë javë tek une, javën tjetër tek ti..." E kështu me radhë. Dhe pritja, shërbimi dhe... Edhe atje kanë këndu natyrisht dhe osht' bisedu e kështu. Po, se argëtime gjeneratat atëhere, domethanë pak a shumë të moshës, apo jo? Që nga martesat e më tej s'ka pasë argëtime e kështu. Vonë pastaj, po, shumë më vonë...

E kështu me radhë, e kështu ka qenë në të gjithë Kosovën, aftësisht, ku më shumë e ku më pak. Po, po ka pasë një gjallëri... Pastaj kanë qenë grupe që kanë këndu, qoftë pa përcjellje fare, po. Që ka qenë më vështirë, po. E mandej ngadal ngadale edhe me përcjellje, janë bo grupe instrumentistësh, po në shoqërinë "Agimi". Ka qenë shoqëria, ma përpara ka qenë shoqëria "Gajreti" u qujtë, në vitet '30, po. Edhe një tjetër, po. Mas luftime pastaj jonë, jonë konkretizu këto t'rive edhe me muzikë t'lehtë. E jonë organizu edhe... vallëzim domethanë, vallëzim. Të dieleve, po. Qoftë në, në një, në një nga ato hapësirat e hotelit, hoteli i përparshëm që ishte, po n'atë vend u bo hoteli tjetër, a po? Në qendër që osht.

**Petrit Çeku:** Në Prizren apo në Gjakovë?

**Zeqirja Ballata:** Jo, në Gjakovë. Aty të shtunën mbramja, po, ende pa shku në shkollë t'mesme, si nxanës i shkollës fillore...

**Petrit Çeku:** Po...

**Zeqirja Ballata:** U organizoheshim, po...

**Petrit Çeku:** E çfarë vallesh, çfarë ?

**Zeqirja Ballata:** Va, va ... Vallëzim me femra domethanë (buzëqeshë)...

**Petrit Çeku:** A ka pasë femra?

**Zeqirja Ballata:** Posi, posi, po kanë qenë t'rralla...

**Petrit Çeku:** Domethanë me muzikë...

**Zeqirja Ballata:** Muzikë e lehtë, po. Po edhe natyrisht kishte edhe kangë e kështu. Edhe... se ishte korza aty dhe domethanë ndonji çift që ishin ose shokë thjeshtë, po... po ndalej atje, ose shiqonte, ose futej mbrenda e kështu.

**Petrit Çeku:** Sa mirë...

**Zeqirja Ballata:** E për shembull ato sa ishte n'shkollë t'mesme, përshembull une e mbaj n'mend atë... Esat Rizvanolli, atë ndonjiherë e shihja aty. Ai me kitarë, po, e shoqëronte, po, ishte, domethanë... Ai ishte në shkollë të mesme, po. E kështu...

**Petrit Çeku:** A na tregoni pak, po mendoj, kur shkutë në shkollë të mesme kush ka qenë pedagog nëse mundeni me kujtu ndonji...

**Zeqirja Ballata:** Posi, po...

**Petrit Çeku:** Kush ka qenë kuadri i shkollës?

**Zeqirja Ballata:** Po, po. Po domethanë në vitin e parë, të dytin, ne kemi qenë të ndarë shqip dhe serbisht, po ma shumë formalisht se sa esencialisht. Sepse shpesh herë ndodhte që veç bashkoheshim atje n'gjuhën serbe dhe nuk pytke kush...

**Petrit Çeku:** Po, osht' praktike me qenë se osht' për muzikë...

**Zeqirja Ballata:** Po. Mirëpo jo, ka qenë edhe gjuha shqipe, gjuha serbo-kroate, nejse... Gjuha frenge ose, nejse dikun-dikun ka qenë edhe ruse në atë periudhë po... Se anglishtja s'ishte atëhere. Po, une frengjishtën për shembull, se edhe n'shkollë fillore kom pasë frengjishtën, po. Ka qenë Engjëll Berisha, po...

**Petrit Çeku:** Ai ka qenë për histori të muzikës, a po?

**Zeqirja Ballata:** Histori të muzikës, ka dhanë disa landë, disa landë. Se ai nuk ka qenë historian n'esencë, ka qenë teorik. S'kishte atëherë historian fare, po. Mirëpo, siç shpesh ndodhë, po, ka nisë me shkru ndonji punim e kështu, për tu botuar dhe kishte një interesim n'krahësim me këta tjerët. Ishte Marku pastaj, që erdh mas një viti. Sevimja, po, që gjithashtu ishte pianiste aktive, ajo gjithashtu nuk e



ka kry seksionin teorik por ishte pianiste aktive. Jepte pianon aty dhe, dhe merrte pjesë në koncerte, po. Pastaj ka qenë edhe profesoresha Morina, Morina. Nji familje Morina, pak si e plotë e kështu jo trup gjatë, po. Jepte pianon, po. Mandej ka pasë disa, disa vllazën. Njëri jepte gjeografinë për shembull, vllau i saj. Një familje prizrenase atje, në Prizren jonë ata. Bile flasin turqisht, po edhe shqip natyrisht, eh.

Krista mandej ka qenë, Krista u transferu këtu, Kristë Lekaj. Domethanë kta kanë qenë gjenerata e parë e shqiptarëve, gjenerata e parë e shqiptarëve, e mandej ka pasë edhe serb, natyrisht. Po, që shpesh herë lëviznin, ndrrheshin, po. Petar Jorgovic për shembull, ka pasë lujtë në Sarajevë, ai i binte trumpetës, po. Si landë e dytë kështu, po. Por teorik ka qenë edhe ai, ka qenë mjaft i sjellshëm. Pinte përndryshe, por shumë i shoqëruar ka qenë... Po edhe i talentuar, i talentuar. Bile ai ka bo dy-tri përpunime shqipe, korale...

**Petrit Çeku:** Po...

**Zeqirja Ballata:** Posi... posi. Tash sdi ku osht', a osht' gjallë a jo. Po, po supozoj që ka shku dikun. Po ka qenë i afërt kështu, i afërt kështu.

**Petrit Çeku:** Ndërsa prej kolegëve dikush që...

**Zeqirja Ballata:** Kolegëve...

**Petrit Çeku:** Që keni pasë...

**Zeqirja Ballata:** Po. Posi, posi ka qenë...

**Petrit Çeku:** Në gjeneratën tuaj...

**Zeqirja Ballata:** Po, po, po...

## Pjesa e Dytë

**Zeqirja Ballata :** Haki Vërmica për shembull, po, se ai ka qenë me moshë pak ma i vjetër po, qaty ka qenë po. Mandej ka qenë Dashnori...

**Petrit Çeku:** Xërxë?

**Zeqirja Ballata:** Ka qenë nji vjet ma i ri se une. Mandej Bu... Bujar, a osht' tash pak si pa qef me kanë thonë se osht', moment... Aziz Stupejani ka qenë që osht' shku në Turqi pastaj, po. Ai ishte andej nga, nga Vuçitërrna, po. Nga Mitrovica ka qenë kjo që është e martuar, gjithashtu kolege ime, po...

**Petrit Çeku:** Po...

**Zeqirja Ballata:** Ka vajzën tash që e udhëheqë këtë festivalin e Pianistët e ri, po e martuar është kjo vajza e saj, po, e kështu...

**Petrit Çeku:** Po, mirë. Si është... si është dukë, a ju kujtohet, a mundeni me na përshkru pak ndërtesën e shkollës së muzikës, domethanë është fjala për atë ndërtesë që është...

**Zeqirja Ballata:** Jo atje, atje kemi ushtru piano, ka qenë të gjitha me piano, pianoino, kemi ushtru, po me orar, me rend. Po, shpesh here duke pritur rendin, po...

**Petrit Çeku:** E keni fjalën për ato dhomat e vogla që janë mbrapa ndërtesës kryesore apo ...

**Zeqirja Ballata:** Po, po, po domethanë, kisha, karshi kishës, djathtas është ajo ndërtesa, partizan i thojshim... atëhere...

**Petrit Çeku:** Tash mo nuk osht' aty jo...

**Zeqirja Ballata:** Nuk osht, ja nuk osht, tash osht ndryshu diçka. Po osht ndërtesa, po me ndryshime, kurse, kurse shkolla ka qenë aty ku osht edhe tash por me disa ndryshime.

**Petrit Çeku:** I kanë shtu...

**Zeqirja Ballata:** Po zgjerime, po zgjerime, zgjerime.

**Petrit Çeku:** A ka qenë salla e shkollës...

**Zeqirja Ballata:** Ka qenë, ka qenë salla, ka qenë, po... edhe aty jan ba do ndryshime, do shtojca janë ba, po kur t'hi nëse ndërtesë tjetër osht' edhe diçka që o shtu, po... Sekretar ka qenë Qamil Niqa nëse të kujtohet ose të kanë tregu, i gjallë, shumë i sjellshëm, po shumë i sjellshëm, tepër i sjellshëm, shumë. Shumë aktiv aty, po... kur kom pasë ardhun bile pastaj m'ka... Ai u konë përkypjekë me, me angazhu, po unë thojsha, "Po unë jom këtu", "Po mirë s'prish punë..." E si t'japish diçka ni kohë, e ta bëjmë një, ta bëjmë një dek honorar kështu paushall. Po nja dy vjet kështu udhëtojsha, po. Mandej se u ndryshu puna, u ba pastaj edhe fakulteti kështu që isha pak ma i angazhuar. Ma aktiv atëherë isha, se isha i propozuar s'bashku me Engjëllin pastaj në ndërkohë edhe me Vincencin.

Para themelimit, se me Engjëllin kemi bo mbledhje, me arsimtar e kështu. Për të biseduar dhe me përforcu iden që ka nevojë shkolla e lartë pedagogjike mu shëndrru në fakultet. Dhe, dhe elaboratin e kemi bo s'bashku me profesor Engjëllin. Dhe pastaj jemi propozu anëtarë konsultativ të, të komisionit... si quhet ajo... si thuej atëherë serbisht s'po më kujtohet... të komisionit për themelimin e fakultetit. Po, kanë qenë gjashtë akademitë, po, se mandej vonë e dini bile, Mali i Zi s'ka pasë atëhere, pastaj e kanë ba. Maqedonia nuk ka pasë, pastaj, po, e kështu.

**Petrit Çeku:** Kështu ta marr njifarë kronologjie po m'intereson ajo periudha, kur keni vendos me vazhdu studimet në Zvi... në kolegjin, me shku në Lublanë?

**Zeqirja Ballata:** Po, '73-shin unë kom pasë... Sidomos '61-shin, '61-shin kom pasë bo një, disa pjesë pra për piano '61, '62. Gjithashtu edhe një kangë për një tekst të një shokut aty, po. Edhe profesoresha Sevime u konë ardh atëhere, se u transferu ajo këtu. Dhe atje e kom pasë lut, nuk e di çfare forme a i kom shkru a, nuk m'kujtohet tash veç, e kom çu kangën e përshkruar dhe e ka pasë këndu Nexhmia, ni kangë, ni kangë e frymës popullore. "Afër malit e pranvere" quhej edhe sigurisht osht' ajo ni kangë, po. Eh, mirëpo, unë pastaj isha shumë i interesuar kështu përmes pianos, më shkante pianoja. E kom pas violën përndryshe si instrument të dytë ashtu quhej ajo. Përveç pianos kishim, ajo ka qenë shumë pozitive se pastaj o nxit njerzit edhe e kanë regjistru seksionin artistik domethanë, jo si instrument i dytë po si instrument i parë e kështu me radhë.

Edhe kështu që gjatë atyre viteve '61, sidomos '62, '63 atje i kom bo disa, ni varg kompozimesh, për piano, ni kangë solo, po. Tekstin e ka pasë bo ni kolege Selva, ajo ka qenë bile andej, këtu afër, afër Prevallës, po. Pastaj se ka qenë kangë solo kështu pak a shumë, jo me në një peshë kështu si ndodhë ajo shpesh here në fillime, po. Kështu që e kam hudhur ate, po. Ka qenë një trio, gjithashtu, po shumë klasik kam qenë shumë standard po. Sa, sa për të njohur komisioni që ka një ide për instrumente, për trio, për material muzikor, për zhvillim, se e kishim edhe dijet po, siç e din, harmonia, format muzikore, masnej kemi pasë bazat e kompozimit, landë.

**Petrit Çeku:** A landë?

**Zeqirja Ballata:** Posi landë ka qenë.

**Petrit Çeku:** Tash nuk ekziston ajo.

**Zeqirja Ballata:** Nuk osht', u hekë ajo bukur moti. Dhe mu atëherë ma ka pasë dhanë, ata e kom rujt se mu ka dhimtë me hudhë poshtë, po. Ajo ka qenë "*Vetar duše, alkatmer miriše*" lulja me ato nuk e di cili, po. Se unë kom përkthi atje pastaj. Se dy, dy fjali, me dy fjali domethanë, se ai ma dha mu tha, "*Evo uzmi*". Ato librat që i kishte mbledh, Mokranci, Mokranci po, është nga qarku i Prizrenit "*Vetar duše, alkatmer miriše*". Qe veç sa, sa {tregon nw fletore} po... Sepse kjo o këndu pastaj edhe në Lublanë u këndu, po. Qe, e kom përkthi se "...dy, dy frynë një puhi, se ç'po frynë një e lehtë puhi me erë të kandshme karafili".

**Petrit Çeku:** Sa mirë.

**Zeqirja Ballata:** E po, aty osht' "*Vetar duše, alkatmer miriše*". Edhe atje ka qenë përpunimi me këte. S'paku kështu di une edhe tha, "*Uzmi*". Po, se atje nuk mujshi me, me thonë, "Valla s'kisha marr, do ta marrë një tjetër". Si nuanës a po jo dhe unë e mora nga kjo përmbledhja, dhe kjo është, kjo tjetra tash. E, qikjo është, dhe u këndu a din, po sërabisht u këndu atëhere, domethanë sërabisht...

**Petrit Çeku:** Të njejtin material e bonët në dy gjuhërat...

**Zeqirja Ballata:** Jo, jo... po, po osht ajo dikun, e kom dikun, po. Mirëpo kta, i kom dhanë vulë, kësaj meqenëse o botu, kështu. Sepse kështu kan ba edhe të tjerët. Kangë shqipe kanë ba, Milojkovic për shembull, po, edhe dikush tjetër nga serbët. Kane bo edhe bullgarët kështu i kanë përkthi pastaj pë

shkak të anës praktike. Po shkrun për shembull “Pesme zemlje Skenderbega”. Osht’ mes dy lufrave kur ata nuk kanë bashkë, nejse intelektual s’kanë qenë të ngarkuar, po, dhe i kanë përpunu. E kjo osht’ domethanë e përpunuar dhe ja si mba... {tregon nw fletore} Ja a pe sheh në sekonda mbaron...

**Petrit Çeku:** Uau !

**Zeqirja Ballata:** Po, këtu osht’ ni bazament {tregon nw fletore}...

**Petrit Çeku:** Kjo është... para... po

**Zeqirja Ballata:** A E A A D, kjo osht’ ‘62-shin.

**Petrit Çeku:** Para Lublanës.

**Zeqirja Ballata:** Po po, po de, para se me shku, para me shku në studime, në shtator ka qenë ajo.

**Petrit Çeku:** E ku keni njoftu këtë gjuhë muzikore, këtë farë?

**Zeqirja Ballata:** Edhe në, edhe në Lublanë është këndu kur marrSot, shpërblimin e, e, e... Universitar atje, eh. Me atë rast domethanë u bo një, një bisede ja kSot, si soji në television dhe i kom ekzekutu disa, disa vepra stilitstike, po. Për flautë, piano, për piano, një profesoreshë ka lujt. Bile për dorë të majtë, se një e kom për dorë t’majtë gjatë shkollës së mesme edhe e kom inçizu vetë këtu, këtu në Prizren.

**Petrit Çeku:** Çka ju nxiti me shkrujt veç për dorë majtë tash?

**Zeqirja Ballata:** Epo ka ka ka, qenë një një një një një nxitje. Domethënë një nga nxitjet për arsye se, duke e përshtatë materialin po, dhe kur fillova ta, ta mësojë, më dukej atëherë e lehtë, e lehtë me të dy durtë. Dhe atëherë, në, në përdorime, në materiale, në kryrje e kështu atëhere erdha në përfundim që do të jetë për dorë të majtë. Kjo ishte. Madnej e shtova, shtova edhe një tjetër. Atje meniherë në studime, ja kushtova ni, ni profesoreshës atje, dhe ajo i ka lujt pastaj, disa here i ka lujt edhe në Itali, edhe në Kroaci. Se në Kroaci i ka kry studimet për piano, mandej ka qenë në Paris atje e kështu, profesoreshë kështu më e vjetër, po. Mandej ni kangë sollo, po, e kom pas këndu në atë farë programin që ishte televiziv dhe kori i radios ishte me katërdhjetë njerëz, po. Është hala gjallë ai dirigjenti, osht’, akademik osht’ tash, jo tash po ni kohë se tash osht’ 80 vjeçar osht’ tash, po...

**Petrit Çeku:** Na tregoni pak kalimin në Lublanë?

**Zeqirja Ballata:** Po, po...

**Petrit Çeku:** Si u dok Lubjana në atë kohë?

**Zeqirja Ballata:** Po, une, une isha atëhere, siç ishim ne të ri, ndodhi Shkupi, Shkupi që u rrënuar, apo jo... Dhe deshta me shku, që shkonin njerzit për me ndihmu rrënimet e kështu. Edhe verës para se me shku, po, vëllau im ishte atje në studime nga fabrika e ksi e tekstilit të Gjakovës, të dërguar atje për të kry shkollën e lartë të inxhinjerit të tekstilit. Edhe, edhe shkova edhe për tu përgadit me konkuru po, qoftë në Beograd, qoftë në Zagreb, qoftë në Lublanë. Edhe ai tha, “Po, shiqo qysh ti edhe po don me

shku në Shkup me ndihmu edhe në provim, duhesh me u koncentru”. Tha... Po po, mas pari niherë se se, shkova në qeshor, po kaloi qeshori meniherë, ku mbahen zakonisht provimet apo jo, provimet pranuse, tha, “Duhesh mu koncentru se qeshori shkoi, nashta edhe jonë kry. Hajde të të mirremi vesh që ta shkrujsh një, një zarf atje...” E quhej a di, *dobisica* quhej atje...

**Petrit Çeku:** Po, po....

**Zeqirja Ballata:** E, ni letër po. Tha, “Ne jemi këtu...” Ata kanë pasë praksin në Duga Resë ka qenë fabrika, po, praksa, po. Edhe unë shkrova, tha, “Pse s’po shkon në Lublanë?” Po, domethanë Beogradin qe pe dimë edhe Zagrebi pak a shumë, po hajt në Lublanë po... Edhe shkova une natyrisht në serbisht, që jom filan fisteku e kom kry kta kta kta, kur jonë provimet e për degën e kompozimit... Unë isha i përcaktuar natyrisht, sepse isha aq naiv sa që thojsha profesoreshës unë du me studiu tek, te ju. E ajo kur e pa që une, tha, “Shiqo...” Kështu m’pat thonë, “S’mundesh me studiu tek une, ti duhet të shkosh në fakultet të studiosh te profesori i kompozimit, po unë nuk jom profesoreshë e kompozimit...” E, edhe kështu me radhë.

Po, edhe nuk u zgjati shumë edhe po m’shkrujnë, po, edhe sllovenisht bile po na e përkthym ata s’ishte ndonjë problem, po. E provimet s’po janë kryer por i kemi në shtator me datën kaq e kaq. Më duket se ka qenë 7, 8, 9 shtator domethonë. Edhe atehere unë nuk lëviza prej atyhit se kishte banesën, se ka pasë plot që kanë shku nga Kosova. Nga këto fabrikat tjera, po tekstili, fabrika e tekstilit ka qenë shumë, shumë e zhvilluar në Gjakovë edhe shumë njerëz të punësuar, çdo i dyti, i treti domethanë thuhej atje që nga qyteti janë të punësuar. Po jo vetëm atje por krejt s’bashku deri te, janë shumë të punësuar. Po, e nejtse, e kështu. Mandej Gilani ka pasë disa të ngjajshme, edhe unë kështu shkova po, shkova ditën po, ishte nifarë mjegulle, nifarë nifarë atmosfere si e zyrtë po, në krahasim me jug e me diell e po. Ishte fillimi i shtatorit e kështu domethanë.

**Petrit Çeku:** A ju duk shumë ndryshe Lublana në krahasim me...

**Zeqirja Ballata:** Po, natyrisht, natyrisht, Lublana ishte diçka super, po (qeshë). Aq ma tepër se kryeqytet po ishte qetë, jo grumbull i madh, jo zhurëm jo... Si që është edhe tash, po. Se kqyre Prishtinën për shembull qysh osht’ tash, osht’, trullohesh ka të ecësh, ndaq në kambë ndaq me kerr. Edhe çdo ditë ndodhë diçka, kaniherë edhe dy here. Siç ishte natën e Bajramit, ditën e Bajramit po. Kur shkova unë përpjetë atje në Kodër të Diellit ku e kemi banesën ishin dy, jo kështu se kjo osht’ një, ishin dy raste po ishin... Ndërrova unë rrugën shkova rrotull pak. Domethanë ose ndërtimet për shembull asnjë shtëpi nuk po ngel që e ke pak hapësirë se vjen meniherë dhe ndërtojnë po zojnë rrugën edhe s’pytë kond fare. Ti duhesh ose me shitë ata edhe ai ti jep kaq banesa, ti duhesh me ik aty po. Ose, kurse njeriu i ka ndërto ato për me qenë i lirë në shtëpi të vet, e se këto nuk duken pa i pa se shihen ato, çdo ditë shihen. Ta zojnë frymën kështu që, domethanë edhe tash, atëhere për shembull e ka pasë, e di, 90,000, 90, 90 jo 100,000, 90,000 banorë.

**Petrit Çeku:** Lublanë.

**Zeqirja Ballata:** ‘63-shin, po. E, mas ni kohe, sepse mas ni viti, ‘64, ne fund të ‘64-shit më duket apo ‘65-shit u themelu akademia, akademia e Zabgrebit, jo e Shkupit edhe disa, po. Ndonjë prej tyre që e kishte regjistru vitin e parë, u kthye po, se filloi atje se s’po m’kujtohet, sigurisht me ndonjë vonesë. Se edhe ne e kemi fillu me ndonjë vonesë kështu në kuptimin formal, nga një muj a kështu. E, ka pasë raste që o hap, o hap pastaj jo në shtator në tetor po o hap në janar për shembull, për arsye të ndryshme. Edhe, e mandej Shkupi së shpejti u bo ma i madh se sa Lubjana, e kurse tash për shembull osht’ Prishtina. Osht’ ma tepër me banorë sesa Lublana, dukshëm. Sepse nuk udhëtojnë aty. Domethanë nuk vijnë krejt në Lublanë, po për shembull unë që isha në Maribor më paten ftu. As që kujtohesh me shku se m’u doke kaloi, kalunë bukur shumë vite unë kisha tre fëmijë atëhere. Po ku kanë ndëgju, kanë ndëgju. Nji, nji drejtoreshë, po, që shifeshim ne në bregdetin Adriatik që mbaheshin seminare të ndryshme. Në piano, e për kitare, e filharmonikë qysh atëhere kom pasë pa nji që osht’ në, në Gjermani edhe kom kompozu për atë edhe e kom pasë dërgu, për filharmonikë solo. Edhe ne jse edhe, i ka, i ka shkru se u ktheva pasë për një moment Bahti Shallohit me ate kemi qenë nga Podujeva, ai pastaj studioi etno-muzikologjinë.

Qitash para disa vitesh dhe ai po m’lajmëron mu, m’tha, “Hajde si t’ja bëj po telefonon një gru dhe s’po e kuptojë”. I thashë unë, “Kur të telefonon herën e ardhshme...” Se i ka thonë në telefon, “E gjejë e bij unë këtu...” I ka thonë që i lutem demek serbisht i ka fol ky natyrisht po, që lajmërohni mas nji ore a nji gjysë ore se e thërras une. I thashë une edhe m’thirri ky edhe pastaj qashtu, po ndigjum po, e m’tha, “Nëse jeni të interesuar” tha, “vini këtu urdhënoni, rri se kemi ndëgju...” Se demek nuk keni mënyrë se atje... Keni ndëgju gjithka domethanë çka ndodhte në Kosovë, po, tha, “Mund të vini sepse ni koleg, po, do të, do të se do ta lëshoj, se do të shkoj, bibliotekën, bibliotekën universitare në atë degë muzikore, eh, po.

Edhe m’u lajmëru aty. Kjo ishte në korrik, po, unë shkova me, me 8 shtator, po. I thashë që do të lajmërohem, edhe kështu shkova po. E kisha fjalën domethanë të Lublana, nuk osht’ ndërru Lublana osht’ shumë interesant, po. Me u ndërtu e me u zbukuru finesat e kështu, po, ndërtesat u ndërtu po jashtë, jashtë qytetit. Qyteti ka shtu ndonji bukuri, ndonji, po. Tash për shembull, osht’ duke u ndërtuar se është në ndërtim e sipër po po presim edhe diçka për shembull fakulteti që ishte në qendër aty Gosposka Ulica, po, domethanë rruga e zotnive, po kështu i bjen ajo po. Afër osht’ biblioteka universitare, afër osht’ festivali, festivali quhet festival ku osht’ hapur dhe mbyllur, po. Osht’ nji sallë tjetër atje, sallë e, si me thanë sallë e trimave ashtu quhet, po.

**Petrit Çeku:** Çfarë, profesorët çfarë kanë qenë në Lublanë?

**Zeqirja Ballata:** Po, po, po profesorët kanë qenë të shkëlqyeshëm, të gjithë në moshë. Në moshë në kuptimin po themi ne këtu, domethënë në moshë të pjekur po, disa. Unë i kom pasë për shembull Branicarin që ka qenë akademik, e kom pasë, rasti, atëherë, po. Grunë e ka pasë prima balerinë në operë dhe në teatrin e operës dhe baletit. Djalin violinist, qika ka studiu te Oistrakhu është hala ajo, është në fakultet, ai ka vdek natyrisht. Mandej ka qenë themelus i degës së muzikologjisë. Se unë atëherë prej vitit të tretë e kom studiu edhe muzikologjinë, fakultetin filozofik, i themelumë ‘61-shin,

po, dega e muzikologjisë. I cili ka qenë vëllau i tij, dirigjimin e ka dhanë kurse ky ka qenë Dragotin Zvetko .

Diku vinin ata me studiu nga Zagrebi dhe thojshin Dragutin, ai i tërheke vërejtjen “*Ne Dragutin, Dragotin.*” Me “o”, eh, po ishte kështu shumë me preciz dhe nuk i vinte mirë, natyrisht, po. Si çdokuj se do ta thujsh emrin e saktë qysh e ka ai. Se unë e kom pasë me qindra herë, herë Zekirja herë Zekirja, Zekirja me do aksente që muj ose jo, po i kom pasë mësu une. Demek, kjo kuja latine se “q” osht’ “k” latine, ne e kemi për q të butë i thojsha, serbishten po, *mehki q*, kta i thojnë *mehki* e kështu nejse. Edhe pastaj kanë qenë domethanë ai dirigjenti, landën e korit po, ka qenë qajo pianisti qe ja kom kushtu, m’ka dhonë dy vitet e para. Pastaj... ka qenë e njohur ajo. Po, ka studiu bile te ai Stanko, pedagogu ma i madh i Zagrebit, i pianos, Stanko, nuk osht’ Stanko...

**Petrit Çeku:** Stanicic, Svetoslav Stanicic.

**Zeqirja Ballata:** Eh, po te ai ka qenë. Mandej ka shku në Francë, në Francë, po, dhe ka qenë pianiste, me koncerte, aktive po.

**Petrit Çeku:** Si e ka pasë emrin?

**Zeqirja Ballata:** Kush kjo, pianistja a? Tatiana Bucca, Tatiana Bucca po. Mandej ajo ka qenë, mandej erdh Dubravka nga Dubrovniku, ka qenë sllovene, Dubravka Tomsic. Erdh me dirigjentin që vdiç edhe ai tash, me dirigjentin që ka qenë në Dubrovnik e ka udhëheq orkestrën e qytetit, tash vdiç ai, duhet të kujohem...

**Petrit Çeku:** Djadrov?

**Zeqirja Ballata:** Jo, jo, Djadrov, jo, për Djadrov mund të flas diçka tjetër, se Djadrov, Djadrov, m’fal, Djadrov osht’ katund Gjadër.

**Petrit Çeku:** Ku?

**Zeqirja Ballata:** Në Shqipni.

**Petrit Çeku:** Qy qy, sa interesant.

**Zeqirja Ballata:** Kom qenë unë në atë katund, apostafat, nejse bash apostafat jo veç, kom kalu, kemi kalu, jemi nal, po. Gjadër osht’. Kur kthen për Shkodër majtas, po, në kodra osht’ Gjadër. Dhe une kom qenë tash vonë po për Gjadër i kom thon dirigjentit Djadrov, s’di a o gjallë a jo...

**Petrit Çeku:** Vdiç para disa viteve.

**Zeqirja Ballata:** E, e kom pas pytë, “Prej nga je, prej nga jeni ju?” Se ai ka qenë shumë i sjellshëm edhe gjithnjë m’ka shku mendja që domethanë ai mbiemër nuk osht’ kroat. Se ka edhe mbiemëra tjerë ka plot varësisht se sa ka njeri prirje, sa interesohet për mbiemrat kështu po. Nejse Gjadër pra osht’ katundi Gjadër. Nejse edhe kur, po, në shkallën e tretë pastaj ka qenë Lucian Malaciano që në moshën

20 vjeçare e ka pasë mbledhjen e kangëve sollo të botuara në Austri, po. Se e përmend domethanë shumë herë si i ri, nejtse, ose gjatë studimeve kështu, ka qenë edhe në Francë natyrisht, te ai pedagogu dhe kompozitori....

**Petrit Çeku:** E çfarë ka qenë estetika...

**Zeqirja Ballata:** Edhe ky ka qenë akademik, urdhno?

**Petrit Çeku:** E çfarë ka qenë estetika dominuese në degën e komponimit domethënë...

**Zeqirja Ballata:** Po, po kështu. Po mund të them se në atë periudhë domethanë fundi jo... Ta thjeshtsojë, fillimi i vitet '60-të pra deri në fund të viteve '60-të kur isha une, po. Unë e kom kry '67-shin po, unë kom qenë pastaj edhe dy vjet... Se prej vitit të tretë e studiova vitin e parë atje. Domethënë, këtu kreuva magjistraturën pastaj edhe dy vjet kam qenë në fakultet atje. Kështu që '69-shin jom liru edhe më kanë marrë meniherë ushtar sepse i kisha mbush vitet, po, bile u çudita atëhere prej nga e ditën ata kështu që prej, prej Mariborit kom shku ushtar. Sigurisht jonë interesu atëherë, sigurisht, "Ku gjindet ky njeri..." Sepse mbas moshë 27 vjeçare ose dënoheshe ose ku e di une. Po edhe, edhe, po, ato vite kanë qenë me fillime të ndryshimeve të guximshme, të gjeneratave që e kishin kry para meje, por nuk ishin të futur mbrenda në akademi, në fakultet. Pra ata gjenerata e re, po, nuk kanë qenë, pra kanë qenë të gjithë, gjenerata e re domethanë ishin 30 vjeçar, 35 vjeçar, 40 vjeçar, po. Ishin shkolla të larta e të mesme, por aty ja, po, edhe... Se kom shku nëpër koncerte natyrisht rregullisht edhe në prova bile paradite gjenerale e kështu.

Qatëhere e kem formu një ansambël që e udhëhiqte Petrić, Petrić, ai e ka e ka të shënu Petrić me "ć" të butë se ata kanë "ć" të fortë por që themi e ëmbla sërbsishtja *tvrdić* [fortë] edhe *mekić* [butë] por ai anej, afër afër Opatisë i lindur. Ai demek thojke sloven tonë kohën në Slloveni, po me Petrić me "ć" të butë, po. Nejtse, ai ka qenë i një grupi, grup ka qenë *Pro muzika viva*, po nga ajo gjeneratë domethanë, lindur në vitet '35, aty janë sjell ata '33, '34, '36, '37. Aty ka qenë një grup që ishin të veçuar dhe ata me siguri dhe do të ngelin domethanë si, si një gjeneratë që pastaj mas... Qatëhere në fund të viteve '60 ne fillim të viteve '70 dhe fillun me dal, po. Edhe përmes anësambllit, po, që udhëhiqte ai ishte kompozitor po ishte edhe i diplomuar po, m'kanë ekzekutu edhe mu atëhere në '66, '67, '68. Se unë u bona anëtar i kompozitorëve të Sllovenisë si diplomova se ne se kishim këtu atë shoqatën. Masi u ktheva une e kemi bo...

**Petrit Çeku:** Domethanë a p'e kuptoj mirë që ata e kanë pasë një mbresë të madhe te ju...

**Zeqirja Ballata:** Po, po se i kom përcjell...

**Petrit Çeku:** Nuk osht' reflektu vetë në akademi apo...

**Zeqirja Ballata:** Po, ishte ajo domethanë, njifarë, njifarë ata ishin stabilizuar dhe nuk, domethënë nuk ishte ndërrim gjenerata. Tash une e di ata masi ka kalu një kohë, se atëhere s'e kom dit, po, po gjatë viteve sa isha unë në, në Lublanë i përcjellsha koncertet, po. Ishte e një gjeneratës pak më të vjetër që ishte e guximshme, që printe ai, Primo Ravos e ka ai, po, flautist që ka ekzekutu edhe në Austri, jo



flautist po fiolist. Pra, po për për pesë, pesë vjet atje ka studiu edhe ka dhanë mësim bile në Vienë, po tash o në Lublanë. Moti osht' në Lublanë edhe e udhëheq ni festival ndërkombëtar. Po pra është baba i tij Primo Ravos gjithëashtu akademik e ka pasë edhe babën akademik, po, një një drejtim tjetër.

E ai printe në gjeneratën pak më të vjetër, ai ka qenë i lindur në '21-shin a '22-shin dhe ka vdek, po në fund të viteve '90, po. Edhe ai ishte domethënë me këta, pjesërisht ishte me këta, kështu i shoqërueshëm, pak a shumë duke ndiku e kështu duke u shoqëru e kështu. Por qatje domethënë ne, ne në gjysmën e dytë të viteve '60 osht' nis po pak me u paraqit këta të ritë, po. Që ishin ma pak të njohur, ma pak të ekzekutuar por me ma pak intereseim nga qarqet më të vjetra por edhe nga filharmonia, nga radio e kështu. E aty pastaj në atë grup ka qenë ky dirigjenti që e përmenda që ka duhëheq me korin kameral. Se unë i them kameral jo kamertal, po se s'ka "t" çdo gjuhë për muzika D-Kamera, muzikë D-genre s'ka po, *camer music* anglisht, s'ka "t". Po ne e kemi thënë gabimisht, unë jom duke e shkruar pa "t", po këta kolegët e mijë e vazhdojnë më të vjetrën.

**Petrit Çeku:** Po duhet me u diskutu këtu ...

**Zeqirja Çeku:** Po, po, nejse po kjo osht' vetëm një element ka edhe elemente tjera, siç osht' Rexho Mulliqi. Une kom ba një 15 faqëshe përveç të tjerash për te, jo Mulliqi, Mulliqi sepse ai nuk osht' Mulla. Se kur osht' Mulla osht' Mulla Hashani, Mulla Hyseni, nuk osht' Mulla, osht' Mula osht' Mushka, dhe ka mbiemëra fshatrash dhe mbiemëra familjesh Mula, pra Mula kanë mbajt mushka në shtëpitë aty qytetet kanë qenë si fshatëra kanë mbajt kuaj e buj e bullica e... E kemi pasë edhe lopë edhe bullicë për shembull për shkak të qumështit e kështu. E familjet e tjera, ishte ai që i thojshim gavadar ai që mbledhke në krejt mahallën, i mbledhke lopët e bullicat e po, paguhej.

Nejse edhe Mula, Avni Mula ka lind në Gjakovë po e domethonë është nga latinishtja ajo edhe e kanë marrë mbiemrin që ata Mula, ata që mbajnë mushkat, se mushkat janë, mushkat mashkull ose femër, po. E jonë të fortë për breg e janë shumë të qëndrueshme dhe i kanë mbajtur, po, shpesh here mushka kanë qenë, jo kuaj po edhe kanë thanë po te ata Mulat, Mulave ju ka ngel ashtu. Pra, ai nuk ka lidhje me Mulla, po i vetmi që ka qenë Içi, Mula, po. Bile edhe Içi që o serbisht por tek ne ai Iç përdoret edhe për një domethanje tjetër, jo pra nga sërabishtja për shembull *siheric*, *siheric* osht' kur t'bohët gëzim në familje, është si një *siharic* për familjen tonë sepse lindi ni djalë mbas kaq vajzave kështu kanë thonë nejse.

Mandej ka qenë një shkrimtar, demek, kishe boshnjak u konë Qamil Siharic që e kom njoft une. Ka vdek ai, ka vdek fatkeqësisht në rrugë këmbësore u shkel, kishe pahiri në Bosnje atje. Se gruja e vet thonte, "Djali im..." Ai është violinist në Sarajevë, "*I na Orlovski nos...*" Domethënë për shqiptarët, hunda demek, si *Orlov*, e kështu. Dhe gruja që s'ishte shqiptare, po, nejse, edhe pra...

**Petrit Çeku:** Mu po m'intereson shumë kyçja juj, momenti i kyçjes të juj në avangardën...

**Zeqirja Ballata:** Po, po unë jom i kyçur, '67-shin jom pranë, po pastaj, se mund të gabohem se nuk e di a ka qenë bash '67-shi apo '68-shi. Jom paraqitë në tribunën muzikore Jugosllave në Opati, po, atje kom marrë pjesë rregullisht, po, aty domethonë kom qenë në korren.

**Petrit Çeku:** Na spjegoni pak Opatinë si...

**Zeqirja Ballata:** Po, po. Opatia ka qenë si atëhere edhe tash osht' po...

**Petrit Çeku:** Po flas për tribunën...

**Zeqirja Ballata:** E, e po, e mrekullueshme, sepse ka qenë e organizuar, organizuar rangi Jugosllav, po. Ka qenë lidhja e Jugosllavisë, ka qenë një këshill i përbashkët, i përbashkët nga gjashtë shoqatat. Po flas tash prej '72-shit se pastaj '72-shin e themelum ne edhe këtu. Por, por kanë qenë domethënë pesë shoqata e kështu me radhë, po. Aty nuk ka pasë probleme, domethanë shoqatat jonë paraqitë pra me anëtarë e tij, ti këtu kaq kaq, veprat po ekzekutojnë, janë në plan për tu ekzekutuar. Kaq kaq, por do t'i ekzekutojmë ne këto, do të na ekzekutojnë të tjerët, po. E thomë thjeshtë unë dhe aty po, ka qenë një këshill i përbashkët pastaj që i kanë thanë, "Epo mire, qe ne po marrim, kështu çka të marrim nga Kroacia, nga Sllovenia për t'i ekzekutuar veprat e kompozitorëve kosovarë..." Ta zamë po, e. Edhe ksi raste ka pasë plot, nga Kroacia, nga Sllovenia edhe nga edhe nga Serbia, po se nuk ka pas ndonji problem kështu, shoqërorë kështu, ato kanë qenë në çashtjet e tjera kështu po atu nuk osht' hetu... Kështu që...

**Petrit Çeku:** Ato jonë interpretu...

**Zeqirja Ballata:** Po, posi jonë interpret. Posi jonë interpretu sidmos, sidomos.... Eh mandej pra se nuk kishim më përpara në Kosovë, s'kishte të diplomuar. Nuk kishte fare të diplomuar se fatqkeqësisht se as Rexho Mulliqi nuk ka pasë diploma. Se e kanë shti në brug para se me diplomu. Vitin e fundit e kanë shti në burg. Dhe e kanë çu në, në në atë brugun famëkeq, që i kanë çu ata tjerët që kanë bo kumeditë se çka, kishë, po ky ka qenë student, po këtë e kanë çu atje. Po edhe me edhe me njerëz e tjerë, te përmendi ni koleg timin për shembull, se kemi qenë në shkollë s'bashku, Teki Dervishin, domethanë në si quhet ai, në Kroaci që osht'?

**Petrit Çeku:** Goli Otok.

**Zeqirja Ballata:** Goli Otok, po. Domethanë ata, e... Kështu që vitin e fundit, kështu që ai s'ka mbri me marr diplomën, pastaj ka ardhë në Prishtinë, në Prishtinë ka ardhë edhe aty pastaj jetoj deri sa vdiq...

**Petrit Çeku:** Mos ta kalojmë rastësisht ...

**Zeqirja Ballata:** E këtu pastaj kom ardh unë, po me diploma. Kom ardh unë i pari, kjo o pak e çuditshme sepse kanë qenë para meje ma të vjetër. Fahriu, Fahriu ka, ka domethanë e ka kry vitin e katërt po hala s'kishte diplomu dhe ka ardh në Kosovë. Pastaj o shty ajo me disa vite edhe ka diplomu mas meje, shumë mas meje. E njehta gja ka ndodhë edhe me Esatin, kanë absolvu edhe pa diplomë se koha e Titos atëherë ka zgjat një mujë, dy mujë, gjashtë mujë, një vjet, po. Varësisht po, e se duhet me pru unë ni vepër të madhe, e po. Bile një vepër të tjera po, po edhe një të madhe qoftë koncert, qoftë simfoni, qoftë ndonji cikël vallesh. Mund të jetë si një vepër simfonike domethanë e kështu me rradhë ose diçka ndonjë operë, janë ma të rralla ato, për atë periudhë kështu të studimeve. Dhe kështu ka ndodh edhe Esati, e edhe drejtë op edhe në radio, hajt, hajt, hajt kanë shku vite të tëra, e kështu.

**Petrit Çeku:** E kur u kthyt në Kosovë çfarë ...

**Zeqirja Ballata:** Atëherë e kemi themelu meniherë...

**Petrit Çeku:** Shoqatën.

**Zeqirja Ballata:** Posi, menjëherë ka qenë iniciativa, po natyrisht aty kishte, kishte, kanë qenë, ka qenë Lorenci, Lorenci, po, po...

**Petrit Çeku:** Për...

**Zeqirja Ballata:** Po, po domethanë nga Kosova. Atëherë s’këm përmend nga Kosova atehere veç si anëtarë i Shoqatës së Kompozitorëve në Serbi. Qashtu ka qenë atëherë, po. Pastaj ka qenë, po Rexhëp Muliqi... Mos u gabofsha, ndoshta ka qenë edhe Marku se ka bo “Zogu i Ohrit”, ka përpunu kangën...

**Petrit Çeku:** Mark Kaçinari?

**Zeqirja Ballata:** Po, ndoshta se s’po më kujtohet tash. Pastaj nuk e di a bash qat vit kur e kemi themelu a kanë qenë Marku edhe ky Kristë Lekaj, se edhe ai ka përpunu, po, Ka qenë shumë, po, shumë elastik shumë i aftë po. Po nuk ka studiu komponimin, përndryshe e që në atë grup ka qenë edhe Vinçenci.

**Petrit Çeku:** Vinçenc Gjini.

**Zeqirja Ballata:** Po, po por nuk mund të them se pak kemi qenë...

## Pjesa e Tretë

**Zeqirja Ballata:** Shtatë, shtatë, nuk e di për çfarë arsyeje...

**Petrit Çeku:** Për me qenë shoqatë...

**Zeqirja Ballata:** Po, me, me themelu shoqatën, po, e, erdh Raufi nga Sarajeva, edhe domethanë, m’duket se edhe Akili ka qenë. Se Aklili, e Akili ka qenë i gjindshëm me shkrime, e, e me ni kangë n’frymen popullore e ka pasë shkruar, e kështu ndonjë kangë përpunim koral e kështu...

**Petrit Çeku:** Rafet Rudi ndoshta?

**Zeqirja Ballata:** Jo jo, më vonë...

**Petrit Çeku:** Me vonë.

**Zeqirja Ballata:** Po se ‘49-shi...

**Petrit Çeku:** Ai ka qenë...

**Zeqirja Ballata:** Po, po, po, e, pra, kjo ka qenë qat herën e parë, prill ka qenë i '72-shit. Po, edhe natyrisht ka qenë edhe ni delegacion nga Beogradi, e kështu s'ka pasë ndonjë problem, po, po mandej kemi qenë të barabartë kështu...

**Petrit Çeku:** Kthehemi te shoqata e kompozitorëve, po m'intereson mos ta tejkalojmë rastësisht në Itali seminarët që i keni percjellë, që i keni pasë, specializimet në Itali...

**Zeqirja Ballata:** Po, po, po, po. Unë kom qenë '68, kom qenë në ato që thuhej në përkthim, specializimet verore për të huaj, po, ashtu quheshin në Venecie. Ka qenë... Unë kom punu me, dhe ato kanë qenë çdo ditë, përveç të shtunës, prej 9.00 dej në 1.00. Eh kështu, unë rastësisht, bile kom marrë bursë për herën e parë, herën e parë. Se ndëgjova aty qe konkuronin, po, bursë për qatë periudhë verore, po, e, po pastaj kam shku vetë edhe ni herë. Kështu që dy herë kam qenë te Virgilio Mortari, e ka së bashku... Osht' më pak i njohur kështu, n'krahësim me kta tjerët të gjeneratës. Goffredo Petrassi, ka qenë përafërsisht sikur ai, ndonjë vit vetëm më i vjetër, po, është më i njohur, po edhe ma i guximshëm për nga mjetet. E mandej kom qenë në Siena, gjithashtu dy herë, po...

**Petrit Çeku:** Siena është e njohur për këto...

**Zeqirja Ballata:** E njohur... Shumë e njohur, po edhe koncerte çdo ditë, e, po...

**Petrit Çeku:** Edhe për instrumente...

**Zeqirja Ballata:** Edhe instrumente, posi, mos pyt, po, aty ka qenë kënaqsi edhe gëzim. Ai ishte Franco Donatoni, ai ishte atëherë pupa që thotë populli, si kompozitor bashkëkohorë, po. Po, ai ka qenë '26-sh atëherë, mos u gabofsha, i lindur, po. Edhe aty mbanim ndeja, po, koncerti ka qenë pa dallim, çdo mbramje, interesant, instrumentistë të ndryshëm. Ai flautisti i njohur Gazelloni, ka qenë, po. Bile aty e kom pa unë për herë t'parë edhe bas flautën, po, alt flautë që quhet, nuk o bas flautë, po alt flautë, po edhe kom shku pastaj një koncert. Edhe u ekzekutu ai koncert ne Opati, për *piccolo*, për flautë dhe alt flautë, po, e mandej kom shku edhe disa herë të tjetër, për arsye se kjo vajza ime i ka, i ka ato, dhe i ka studiu, po...

**Petrit Çeku:** Lulja?

**Zeqirja Ballata:** Lulja (qeshë), po, nejtë... Edhe atë koncertin bile o dalë i shkurtë aj, kështu, o dalë mjaft i shkurtë, po, mirëpo, se '78-shin apo '79-shin, po, o realizu ajo, po, bile kroate osht' ajo, e gjeneratës të vjetër, se s'po m'kujtohet emri, ajo e ka pasë ekzekutu. E kështu domethanë, pra, ishte qajo periudhë, pastaj ne gjithnjë duke u bo ma shumë, dhe deri në '90-shin, '90-shin, edhe '90-shi ka qenë aktiv se po kthehna te shoqata, dhe lidhur me shoqatën, po, domethan dej në '90 e... po, kemi bo pastaj festivale, se unë kom qenë dy herë kryetar i shoqatës...

**Petrit Çeku:** Veç ju kisha lutë të kthehemi kronologjikisht te shoqata, prej '72-shit, domethan vitet e '70 i keni kalu në Kosovë apo në...

**Zeqirja Ballata:** Po, po, po, po, në Kosovë, Kosovë, mirëpo kom shku, kom shku, se ishte fjala për ato specializimet, dy herë, po, dhe, edhe herën e dytë, pra, aty kom shku. Si herën e parë, si herën e dytë kom shku me shpenzime të mia... me tren, po, me tren, po...

**Petrit Çeku:** Si ishte jeta në '70-tat si kompozitorë, a mujshit me jetu si kompozitorë në vitet e '70-ta?

**Zeqirja Ballata:** Po, po, unë për veti po. Se unë kom marrë pjesë shumë herë. Rasti ka dashur që kom, kom, qoftë si pianist, i padiplomuar, se kom pasë landë kryesore, po kom qenë aktiv, e qoftë si shoqërues, përcjellë violinen, përcjellë flautën, përcjellë klarinetën e kështu, po. Jo vetëm ktu, në Opati shumë herë. Me gjithë kta që kanë qenë katër, që na kanë ekzekutu, ata solistet, po, ai ka qenë program, atëherë unë jom paraqit kështu edhe nuk ka qenë ndonjë problem kështu. E kështu që, domethanë, ose ktu për shembull se pak më imitonte mu Fahriu, qe po i bi unë pak kështu... Kështu pak me ndonji gjest se kështu, po, po. Se te pianistet është ajo, kur të ekzekutojnë, kështu, pakëz, ose ndonjë ulje, ose ndonjë lëvizje, ose kështu, ose per shembull, nejse më vonë osht' kjo, n'fund të performances {godet tavolinen me dorë si piano}, me piano për shembull që i kom perdorë ato, po, në fund, po, ose glisandos, ose, ose, kështu {godet tavolinën me dorë si piano}, po, ose, ose, në kto 20 vjetët e fundit domethanë është shkru, janë te shkruara notat, po me ni shenjë të posaçëm, ato i ven gishtat, i ven gishtat po nuk luhen, po, vetem nuk ndegjohet...

**Petrit Çeku:** E çfarë është efekti...

**Zeqirja Ballata:** Efekti? Po është nifar efekti, e sheh me sy, po nuk ndëgjohet, po, osht' këngtari që po këndon ose mban tingullin, por, po, osht' edhe kjo per shembull, merr nja dy a tri, po, ku përdoret, po, osht' per dy këngtarë dhe piano. E kështu domethanë, ajo ka vazhdu pastaj meqenëse kam qenë korrent, kom lëvizë, masnej rasti pra, i shkuarjes atje mas '91-shit, edhe une nejta aty, e kom lëvizë atje se ishin mundësitë, shkojshim...

**Petrit Çeku:** Në vitet e '70-ta a organizutë ndonjë koncert ktu në Kosovë...

**Zeqirja Ballata:** Po, posi, posi, posi. Koncerte, koncerte të shkollës së lartë. Menjëherë në '71-shin, kur jom kthy, se unë pastaj shkova ushtar, u ktheva në Lublanë, u barta prej atjehit, po, po kom ardh ne shtator ktu, kam qenë në '71-shin. Menjherë pastaj ndoshta në vitet e ardhshme, po, kemi organizu në Shkollën e Lartë, kom marrë pjesë si pianist me veprat e mia, po edhe ndonji, ndonji student apo studente, po. Ose ndonji kangë solo... Domethane unë jom bartë pastaj, sepse siç ndodh ajo gjatë studimeve, t'bjën me ble kështu libra, partitura, e kështu po edhe pianinon, po, po. Unë isha i bindur atëherë se domethanë nuk ka nevojë me bartë pianon, pianinon prej atjehit, po, se kur t'vi në Kosovë ma bojn pianon meniherë (qeshë), po. Andrron njeriu kështu, menon, po, edhe prandaj e shita, ndoshta edhe për arsye se bartja ishte, unë edhe tash kom se e kom ni pianino atje edhe osht' ni banesë qe e kom, që ma kanë dhonë ata, po.

Mirëpo, dhe ato jonë mbledhë, mas pari kom shku pa bajt asgjo, mirëpo u mbledhen, domethanë, të tjera libra, dhe osht', tash kom nis me i bart prej atjehit, po, sidomos ato që mandej i kom bart prej

ktuhit, por janë edhe të tjerat që janë në sllovenishte, ka edhe gjermanishte, gjuhën nuk e njoh, por lexoj fjalë te caktuara, po. Kur flitet për orkestër, e kur flitet për... që njeriu i kupton ato, po...

**Petrit Çeku:** Pse u bartët në Prishtinë? Çfarë...

**Zeqirja Ballata:** Po, u barta se, jo, ishte domethanë, isht shumë, e kisha të qartë unë qe duhet të kthehem, ashtu kom vepru edhe me djemt. Veç se me djemt kom pasë pak punë, po, se nuk ktheheshin. Mirëpo njoni me tjetrin, po... Unë i kom, unë i kom financu, bile sa isha atje, sa isha në Maribor, po, edhe i kom percjellë me krejt gjithnjë me makinë bile, po, t'u shku t'u i vizitu ato, po...

**Petrit Çeku:** Si dukej Prishtina ne vitet e '70-ta?

**Zeqirja Ballata:** Po. Vitet, vitet, po vitet '70-ta domethanë ishin me ndryshime shumë pozitive që ndodhën... Nejse mas pari në '68-shin, '68-shin, domethanë ndodhet në Prishtinë, domethanë jo Republika e Kosovës jo kështu. Ishte një nxitje për ndryshime. Ngjarja tjetër ishte themelimi i Universitetit, meniherë '70-shin, bile '69 - '70, po, formalisht osht' '69 po '70-shin ka fillu. Ajo ishte një ngjarje, ngjarje. Sepse në fillim kishte disa fakultete, jo të gjitha fakultetet, në shumë, në qato fakultete jo të shumta kishte një mori në gjuhën serbe, domethanë që jepnin msim edhe në serbisht edhe shqiptar, po. Edhe mirëpo gjithnjë duke bo ndryshime, duke u shtuar fakultete, po.

Pastaj viti '74, viti '74 alamet viti, po. Me përgatitje shumë me maturi, me mençuri, u bo barazia, u bo domethënë barazia me republika tjera, nuk u qujt republikë, po u bo barazia se u bo kushtetuta. Jo si quhej ajo atje, që quhej si me qenë ni ligj për ni shoqatë. Ishte krahina autonome Kosovë Metohisë. U bo kushtetuta që çdo vendim qe mirrej, mirrej nga gjashtë republika dhe dy krahina. Ajo ishte një, një, një kulm, kulm qe u bo prej viteve '60, se edhe para '68-shit ka pasë do, do, do përpjekje, kështu, duke u shtuar shkollat e larta... Shkollat e larta pedagogjike, që ishin shumë domethanse ato për arsimin, po, për kulturën, për nxitjet, e kështu që, domethanë, ka qenë menjëherë një gjallërim i madh, po. Dhe u themelu konkretisht fakulteti, domethënë dega e artit muzikor, ishte prorektor Gazmendi. Prorektor ishte...

**Petrit Çeku:** Gazmend Zajmi.

**Zeqirja Ballata:** Gazmendi. Prorektor ishte një qe e kemi ktu antarë, po, shumë i sjellshëm, shumë i mirë, po, më i vjetër pak se ai, ndonëse ai vdiq i ri, po, mirëpo ai i tha, "Të lutem Gazmend," tha, "ti prorektor dhe ti mirresh ngapak me muzikë, ti do të udhëheqësh, unë mund te vi kohë mbas kohe sa për shembull kështu se domethanë," duhej... pra, njeriu i parë i univerzitetit duhej me qenë. E tha ti po, e ai Gazmendi siç ka qenë super për gjithçka, po, edhe se e di unë se kom qenë une bile ma n'kontakt se sa Engjulli, ne kemi qenë së bashku por kemi bo edhe ndonjë aktivitet, po. Kur ishte qështja e pranimit pastaj se ishte ma së pari planprogrami, pastaj ishte sa numri i angazhimit të pedagogëve për n'fillim. Pastaj ishte numri i zgjidhësve, zgjedhjeve, ata e kanë bo, kurse ne ishim bashkëpunëtorë, si quhej, po, shtojcë te atyre, një ndihmë. Po, se kishte raste kur për ndonji nga nesh për shembull nuk e njifnin ata, domethanë, si kompozitorë, si Raufi ishte në atë rast, që është '45-sh, pra dy vjet ma i ri se unë, po, kur ishte rasti, po, duhej pak me folë, po.

Ose për shembull ni violinist që e kemi pas osht' serb ai, nuk e di se ku osht' tash, po, ai ka qenë ni violinist i dobt përndryshe, po ne e kemi pasë sistem sa për të pasur, po, një, i kishim atëherë, po, edhe për shkak të kombësisë e kështu. Kështu që domethanë, ishte një kthesë fillimi i viteve '70-ta dhe i tërë '70-shi e pandërprerë mandej, pandërprerë. Se pastaj ndodhën shumëçka tjetër, kto kanë qenë domethanë, kto janë ndërthurë ngjarjet, nuk kanë qenë të shkëputura. Domethanë çështja e '68-shit ka qenë e shkëputur nga liria, nga demokracia, nga studimi, nga gjuha amtare, nga shërbimi n'gjuhën antare e ku i di unë domethanë. Edhe kulmi ishte në '74-shin pra, që pastaj ka vazhdu ajo, po...

**Petrit Çeku:** Ndërsa akademia u hap në '75-tën...

**Zeqirja Ballata:** Po, po, në '75-shin, edhe u përgadit më përpara, u bo zgjedhja e ni baze fillestare, po. M'duket se kemi qenë gjashtë atëhere të zgjedhur. Se edhe thirrje duhej domethënë, disa thirrje duhej me... jo asistenta, se s'mund të fillosh vetëm me asistenta, se formalisht me asistent ti s'mund të punosh. Asistenti duhet të jetë me pedagogun për t'u përgaditur me marrë thirrje më të lartë dhe për të marrur një përvojë gjatë asaj. Tash, tash keq që mejherë fillojnë me punu, po, e kështu. Tash u ndryshu situata, shpesh herë edhe për të keq, apo jo? Nejse, edhe... pra, osht' fillu mandej çështja në një gjuhë, në gjuhën tjetër, e kemi përmbajtë një për shembull... tash s'po din kta me mbajt, sado që s'je, nuk je, asnjë nuk osht', po, në qeveri për shembull, po. Domethanë nuk osht' një me tre, se nuk osht' ai proporcion ashtu, osht' një numër i vogël, po, n'krahasim me përafërsisht dy milionshin, se kshu domethanë... Po, ju kemi përmbajtë, edhe nuk ka pasë ndonjë problem...

**Petrit Çeku:** A ka pasë jetë koncertale në Prishtinë në atë kohë?

**Zeqirja Ballata:** Posi, po, ka pasë, po, modeste por ka pasë. Ma së pari, posi, ma së pari domethanë, koncertet, Shkolla e Lartë po flas... që nga Shkolla e Lartë, natyrisht, po, gjithashtu Shkolla e Lartë, kori, po. Mandej hala në kohën e Shkollës së Lartë ka pasë orkestra në radio. Ka pasë edhe grupi koral, ka pasë pastaj ma vonë, edhe kori i fëmive. Kori i fëmive shumë serioz, kangë të kompozuar për fëmi...

**Petrit Çeku:** Ndërsa nëse s'gaboju edhe ditët e muzikës moderne ju i keni organizuar, a po jo? Kanë qenë vite t e '70-ta?

**Zeqirja Ballata:** Po, po. Posi, po po '69, '69, po. Unë kom qenë, po. Se deri në '67-shin në të vërtetë, nejse, mu m'kanë propozu për kryetar, por Vahide Hoxha, që ishte e shoqja, po, ishte afër. Edhe ajo propozoi ata... Lorencin. Bile saktësisht një letër ka qit, po, aty, po. Edhe ata, ata m'propozun mu, mandej Severin Kajtazin si nënkryetar. Masnej anëtar, sekretar, Fahriun. Ky tresh ka qenë. Atëherë unë meniherë u çova thashë, "Unë propozoj Lorenc Antonin", kompozitor më i vjetër. Meniherë u çu ai Severini, tha, "Atëherë, ju lutem, por që se aprovohet që të jetë kryetar Lorenc Antoni, unë e propozoj kompozitorin Ballata", n'vend t'meje demek. Kshu që, unë u bona nënkryetar. Po, dhe Fahriu sekretar.

Masnej nuk kaloi një mujë edhe u fjalos (qesh) Fahriu me Lorencin. Edhe atëherë ishte Lorenci kryetar, edhe Lorenci meniherë e propozoi aty ne që ishim treshi, atëhere ishte tresh se s'ishim shumë, ishim gjashtë a shtatë gjithsej, jo shtatë ishim. Shtatë ishim pra. Edhe propozoi Akilin atëherë, edhe ajo deri

në '67-shin m'duket, vazhdoi ajo. Po, pesë vjet. Mandej, ashtu m'duket, po. Po deri në '69-shin kam qenë, qathere une m'duket e kom dorzu dikujt tjetër, m'kujtohet tash, pra. Atëherë kemi qenë aktiv në ditët e muzikës në Serbi, ditët e... ajo ish prej '69-shit, ditët e muzikës kosovare, ditët e muzikës në Vojvodinë, se u bon edhe atje. Shkojshim ne atje, ata vishin ktu dhe ne ekzekutonim. Mandej, natyrisht, njëkohësisht, edhe ne, edhe ne në fillim nuk ishim shumë, po, ishim qata që ishim, po. Në Opati, po. Mandej java e kulturës kosovare në Zagreb, po, ku merrnim pjesë edhe si, në Zagreb kom marrë pjesë, po. Domethanë kishim muzikë, arti figurativ, letërsia, po, kanë dhanë edhe ligjerata tanët. Për shembull, ky Hasan Mekuli, që ata lavdonin thojshin sa mirë po spjegon, po, në serbisht, po, atje. Janë mbajt disa javë, disa raste domethanë n'vite ku e di unë, çdo katër vjet a pesë vjet a që organizoheshin.

Domethanë vitet '70, po, janë shumë domethanëse nëse zgjerohemi, po, natyrisht pastaj nuk e ndërprej ato po duhet të thuhet '70, '90. Nji, nji bërthamë pak ma e gjerë tash, që s'bashku prapë një periudhë tjetër shumë e rëndësishme, shumë e rëndësishme. Pastaj dihet se çka ndodhi, apo jo? Edhe ka qenë nji, nji domethanë, nji zbrazëtirë atëhere, por ajo zbrazëtirë nuk ka zgjatë shumë, po. Sepse prapë u bo domethanë '90, '91, '92, '93-shin veç fillunë, filloi mësimi, domethënë filloi vetë-administrimi n'qato kushte pa rroga pa... Megjithëse qysh '91-shin hala pa shku unë atëhere ne merrshim ka 20 marka, por na që mblidheshin në ato, s'di se si mblidheshin. Pastaj '93-shin, ishte pak një periudhë tjetër, po, që nejse u kurorzu në 2008-shin. Kurse prej 2008-shit, tash është një periudhë tjetër.

## Pjesa e Katërt

*[Kjo pjesë e intervistës është realizuar me 26 janar, 2017]*

**Petrit Çeku:** Ju i vazhduat aktivitetet krijuse gjatë viteve t'tetëdhjeta?

**Zeqirja Ballata:** Po...

**Petrit Çeku:** A vazhdojke ende lidhja me, me...

**Zeqirja Ballata:** Po si...

**Petrit Çeku:** Me Jugosllavinë, me kompozitorë të Jugosllavisë?

**Zeqirja Ballata:** Po, po, po. Ishte një ftofte, kshtu një flladitje se (qeshë) po megjithatë, megjithatë nuk ka pasë... po. Ai rasti që përmenda kalimthi, se fillova m'duket me, me... po, e ndërpreva ndoshta, nuk e thashë deri n'fund. Dy herë, në dy, në dy mbledhje e ka përmën, mbledhje këshilli për marrëdhënje me botën e jashtëm siç e thashë, po, të lidhjës së kompozitorëve të Jugosllavisë...

**Petrit Çeku:** Po...



**Zeqirja Ballata:** Dhe udhëheqësi që ishte gjithashtu kompozitor, po, ky ka qenë përfaqësues i kopozitorëve të Bosnjës e Herecegovinës, kurse tjetri ka qenë kompozitor beogradas, shumë i matur shumë i... po. Edhe në një moment të caktuar kur e përmendi s'dyti herë që u pamë tha, "Ju lutem kolega, neve nuk na takon atë, le t'a shqyrtojnë në vend ku jeton kolegu Ballata." Edhe ajo murrë fund prej atyhit, po, prej atij momenti, po. Po s'ò çudi që mund t'ketë pasë kontakte me ndonji... E kshu domethonë... ishte, kemi qenë së bashku me të shpesh herë, po. Bile kom qenë unë në Sarajevë, kemi pasë manifestim. Jemi pa aty, jemi pa. Sepse ka pasë shoqe ni kolege që ka qenë n'shkollë t'mesme ktu, e ajo e ardhur e ka pasë kry, kështu që ai ka qenë i martuar me të.

E kështu, domethonë, ka kalue, ka vazhdu jeta normalisht. U dashtë me punu, me kriju, me qenë n'pune, festivalet kanë vazhdu, bienalja e Zagrebit... Sidomos Opatia ka qenë për kompozitorët, po se jemi taku atje, jonë bo krahasime, biseda, biseda. Na kanë ekzekutu vepra tona, ndonjihere, ndonjihere n'raste t'rralla edhe ne të tyre. Ne të tyre domethonë deri tek ndonji instrumentist, po, ku ishin veprat me përbërje t'vogla. Violinë, piano, za, piano domethonë sepse kështu ishte, kështu ishte. Domethonë t'gjitha... të gjithë pjesëmarrësit, qofshin orkestra, ansamblet e ndryshme ishin nga vise t'ndryshme që vepronin edhe jipej... Gali kompozitori i Serbisë jipte, eksekutonte orkestra ose ansambli. Slavko Osterc për shembull, që ishte shumë i njohur atëherë, po.

Atëherë ishte ndonji vokal instumental nga Bosnja, ose nga Serbia e jepshin sllovenët po me... Kështu që, ekzekutoheshin vepra të të gjithëve me ansamble të ndryshme të vendit, po. Edhe ishte një lehtësi shumë e madhe sepse jo të gjitha qendrat ishtin t'forta për të gjitha përbërjet e ndryshme orekstarale, vokal-instrumentale, korale, kamerale e kështu... Pesë-gjashtë instrumentist po, jo me marrë për ni vepër. Po ajo që, ajo që ishte, që vinte ansambli prej Maqedonisë ta zamë, po, ai i merrte edhe këto veprat tjera që jonë të ngjashme krahas atyre që ishin kompozitorë të Maqedonisë. Edhe kështu që ato, ato programe që ishin n'ansamble t'ndryshme ishin nga republika të ndryshme dhe nga dy krahinat. E kështu që ajo pastaj ka vazhdu deri sa, deri, deri në shpërbërje të Jugosllavisë. U ndërpre për ndonij vit, apo dy-tri vite, mos t'gabohem. Mirëpo, Kroacia pastaj e ka vazhdu atë festival për veti...

**Petrit Çeku:** Po, madje edhe unë kam qenë aty...

**Zeqirja Ballata:** Eh, eh... po. Unë hala s'po mrrij me shku, moti po planifikoj, po, me majtë n'mend dhe me planifiku se n'mend... osht' përafërisisht n'qatë kohë osht' ajo, n'vjeshtë osht' ajo...

**Petrit Çeku:** Në nëntor osht', po...

**Zeqirja Ballata:** Në nëntor, qashtu i kemi majtë, fundi i tetorit, fillim i nëntorit, qashtu, po qashtu gjithnji, po... Edhe, edhe po edhe s'jemi oragnizu, ne kishim mujtë m'u organizu kto kohë pas kohe. Dy, tre, qoftë me kerr, qoftë me ndonji mjet tjetër, kemi shku edhe me ajroplan. Qysh atëhere se jo tash, po, eh... Mirëpo, u bo, u bo njifarë shkapërderdhje përndyshe. Mas, mas 91-shit, fatkeqësisht... Kemi lëvizë mjaft prej nesh. Ka raste, disa ka raste edhe që jonë shku, pastaj jonë kthy se nuk kanë pasë raste kështu për t'u vendosë dikun për vend pune, natyrisht. Edhe, kështu që disa kanë ngelë, disa jonë kthy edhe shumica, shumica jonë kthy kështu nga, nga lëmi të ndryshme t'muzikës. Nuk ka pasë shumë raste kështu, po megjithatë jonë, kanë qenë disa raste.

Krijimtaria u zgjeru, jonë zgjeru antarët. Nejse u bo një ndërprerje e shoqatës të kompozitorëve prej, prej '91-shit deri 2011. Prej 2007 jom interesu unë, jom përpjekur për ta rifillu por nuk ka pasë përkrahje të sigurtë. Me kundërshtu, kërkush s'e ka kundërshtu po përkrahje të sigurtë, jo. Masi jom kthyer në 2007, po, pra jom përpjekë po ka... osht' shty ajo, osht' shty, osht' shty, osht' shty... Edhe në një nga mbledhjet me pak njerëz, po, kemi vendosë që të ripërtrihet shoqata dhe kemi fillu tek në 2011-shin. Dhe në 2011-shin veç u realizu koncerti, me atë rast këtu e kemi vazhdu, jo në Kosovë mo, në Gjakovë, po. Për shumë arsye, po, që, mendova që ma praktike, megjithatë. Edhe se, edhe se do t'bahen salla, se u folë edhe moti, u nda toka e s'u ba asgjë, jonë shfrytëzy t'hollat me vite të tëra, po.

Edhe, kështu që megjithatë e kemi fillu por interesim të madh nuk ka sepse kjo ndërpreu edhe shoqatat e tjera. Ka pasë shumë shoqata, Artistët Figurativ, Pedagogët Figurativ. Të gjitha këto shoqatat e arteve kanë pasë ka dy-tri, domethanë specialistike. Mandej letrarët kanë vepru me shumë organizim dhe n'vende t'ndryshme. Letrarët hala mbahen dej diku po s'janë si kanë qenë atëhere, jonë t'shpërndarë po u bonë edhe shumë kështu si shtëpi botuese. Jonë disa forma të tjera të botimit e kështu, jonë zvogëlu, jonë pakësu takimet e poetëve. Nuk e kanë atë gjallni që kanë pasë, shpërblimet jonë fatmirësisht ende dhe ato zakonisht po qashtu, po, po... Kanë dalë do farë rigrupimesh të tjera.

Kjo nuk osht' t'u ndodhë tjetër kund, jonë bo rigrupimet e tjera por ato institucione, asociacione, pra shoqata, kanë ngelë, kanë ngelë gjithkunj, kanë ngelë. Dhe jonë njësoj t'forta, me organizime, kanë emër, emër. Po, për arsye se edhe për çdo manifestim muzikor, pysin ata, kush do të ishte anëtar i ndonji konkursi muzikor, apo ndonji festivali, apo... Si anëtar të shoqatës, sipas drejtimit, profesionit, e kështu. Manifestimi për shembull për... po, pytet shoqata, organizon, po, çfarë ansambli, për çfarë kangësh. Për shembull, në Slloveni që e bëjnë, e bëjnë rregullisht, po, eh, gjithka. Prej Maqedonisë e përpjetë jonë aktive, kështu që... po, ndoshta do të, do të rifillohen edhe shoqatat tjera...

**Petrit Çeku:** Nuk po e shohin njerëzit sa osht' e randësishtme...

**Zeqirja Ballata:** Po, po ashtu, po. Unë pastaj, pas ardhjes kështu, kam vazhdu prej 2007 deri 2013 domethanë, deri në moshën 70 vjeçare ku, ku edhe ashtu u konë duftë mos me u angazhu, po le t'hijnë të tjerët të rijtë. Ndonëse n'vendet tjera ka, ka, ka yhaa, kalojnë 80-shin, po. Edhe pse janë më t'zhvilluara ka të ri e të vjetër. Po nejse, kjo u bo që domethanë mos ishte... Gjithnjë të freskohen, po. Ndonëse në raste të caktuara ka që edhe mungojnë me shumë përvojë, po. Unë vjet isha, një nga shkuarjet, bash në Lublanë, po, isha në fakultet atje. Isha n'qytet edhe bona një vizitë atje, me një nga ata kompozitorët. Dhe po rrijmë aty, isha kështu, po, dhe ai kërkonte në kompjuter, ai kompozitori që i njoftun, ma i vjetër se unë, po. Bile e kom bo një, një, një... Se ka qenë dekan atje, po, dhe jemi njoftë qysh, qysh gjatë studimeve. Ka qenë dekan fakulteti dhe e kishte një përvjetor ai, po. Edhe kom bo ni vepër, e kom ekzekutu atje, po. Dhe ajo vepër me pak fjalë që mos të ndalem, jonë elementet e shkronjave të emrit dhe të notave që frymojnë emrin.

Po, ajo osht' mjaft e komplikuar, aty shkronja ku osht' paraqitet. Të emrit dhe mbiemrit. Aty ku s'ka shkronja jonë pastaj tingujt që unë i kom... Po edhe ata jonë tinguj natyrisht, A, B, C, e kështu me radhë. Edhe e kom thonë shkurt, ni titull shkurt që nuk osht'... eh, po... Aha, "The name" e kam qujtë,

“The name”, “Emri”. Veç kështu domethanë, as sllovenisht jo, bile, po, e kështu... Po e din ai, po, natyrisht. E ka shiqu edhe masi, masi, masi osht’ ekzekutu. Se osht’ ekzekutu atje, po. I kom tregu (qeshë) dhe ia kom dhonë partiturën (qeshë) edhe bile tha, “Pse s’më tregove përpara?” E kështu, s’desha me e bo t’madhe atë punë. Po, osht’ për nja gjashtë, apo shtatë, po, ansambël... Se ata kohë mbas kohë e caktojnë, po, për kto ditë të muzikës sllovene që i qujnë ata. Se ka edhe që s’jonë sllovenë aty po festivalet jonë të Sllovenisë, jonë t’meçëm ata.

Në Slloveni ka ma shumë, ma shumë shqipëtar e më pak të tjerët se sa në Slloveni. Mirëpo Slloveni osht’, sllovenishtja osht’. Menojnë, ata që s’dijnë menojnë se Sllovenia osht’, stafi slloven, vetëm slloven, ka ndonji, po, nuk ka ndonji, ka shumë... Shumë kroat, shumë serb, shumë shqipëtar, shumë maqedonas. Natyrisht nuk po mendoj se ka 50 përqind, po pakica ka shumë. Nuk osht’ qështje e tre përqindëshit, a t’pestit, a dhjetë përqind, e nontëdhjetë përqind qenka. Nuk qëndron ajo.

**Petrit Çeku:** Si kalutë vitet e ‘90-ta atje gjatë luftës, luftërave?

**Zeqirja Ballata:** Po kështu, po, po. Ata, ata kanë qenë, ata kanë qenë t’organizuar.

**Petrit Çeku:** A ju gjeti lufta e Sllovenisë, në Slloveni?

**Zeqirja Ballata:** Ajo, jo, ajo ka qenë, ka qenë si fundi diqysh. Se unë kom shku me 9 shtator. E ata as, as nuk kanë qenë shtet. Pra... po as e qetësuar situata, po për fat t’mirë, për fatin e mirë të tyre efektivisht nuk ka zgjatë ajo. Kështu, edhe thonë ata objektivisht, nuk e thonë t’gjithë ashtu, po objektivisht ka zgjatë nantë ditë gjithsej. Po kanë pasë edhe fat që i kanë përkrahë n’mënyrë indirekte Italia, Hungaria dhe sidomos Austria. Se ka nji, ka nji, ka nji të sllovenëve në Austri, kryesroja i kanë marrëdhanjet e mira, e kështu.

**Petrit Çeku:** A u rehabilitu shpejtë Sllovenia prej...

**Zeqirja Ballata:** Osht’ rehabilitu, po. Osht’ rehabilitu sepse ata nuk i kanë dorëzu armët, ato të rezervave, rezervistëve e kështu... Siç jonë ba knej, knej jonë ba. Dhe ata e kanë pasë ma lehtë se n’fund pastaj e kanë mendu edhe atë ma s’paku, veç sa me, sa me, po... E kanë pasë qëllimin edhe në Kroaci natyrisht se ka qenë krahina, krahina po, krahina (qeshë) krahina, krahina po ka qenë plotë... Ka pasë, nji krahinë bukur e madhë, popullatë serbe... E kështu që ajo ka qenë gati si vrimë e fundit e kavallit, “A po e marrim edhe qetë vrimë, a jo? A po e lojmë se bon kavalli edhe pa qatë vrimë”. E kështu, edhe kanë qenë, kanë qenë edhe të ashpër, kanë qenë, po. Se thojshin, po, le t’shkojnë alpet, alpet Austriake, atje le t’shkojnë ata. E kështu që ata jonë mbrojtë, nuk jonë dorëzu, qysh përpara s’jonë dorëzu. Se ato përpara jonë mbledhë, jonë haru kur jonë mbeldhë bile. Mirëpo ata i kanë mbajtë ato. Jonë marrë vesh, “Ne po i mbajmë kështu...” N’kohna të qeta, natyrisht u bo ajo punë. Edhe kanë qenë të organizuar shumë, po. Nji, nji ka pësu shumë keq, po, e ka shkëlë...

**Petrit Çeku:** Tenka...

**Zeqirja Ballata:** Tenku. Domethanë ka qenë një tmerr se ka... Nejse jonë largu t’gjithë, një ka ngulë kambë qaty, po, edhe e ka shkelë tenku, po. Nuk jonë vra shumë. Kanë qenë me siguri pak ma,

periudhë pak si ma e vështirë ajo se e vonshme ka qenë, e fundit, po. Edhe kanë qenë të organizuar. Kazermat kanë nisë ma i marrë ma së pari, me i marrë, me pastru, sllovenët. Me i liru, se ka pasë oficer edhe serb, e kroat, e kështu. Kanë nisë me i marrë ato kadal kadale, kështu që jonë forcu, edhe të organizuar, po. Se organizimi ka, jo vetëm çashtje, “Jo kemi trima, jo...” Organizimi, profesionizimi, përkushtimi, po. Kështu që ajo pastaj osht’ shpejtë... U qetësu situata. U nisë një kahje e re prej një shteti t’ri u ba... Edhe, edhe për pranimin si shtet u ba shpejtë. Domethanë u ba shpejtë edhe me lehtësi. E kanë pranë menjherë.

Madje, madje u bo edhe parja, edhe parja u ba një kohë. Mandej u liru se u ba kjo euro, e këshu me radhë. Kështu që organizimi i fortë, shumë i fortë, po. Mandej ka pasë edeh ardhacak shumë ga viset tjera, që kanë punu aty. Ardhacak jo vetëm thjeshtë puntorë po edhe intelektual, po. Aty ku kom qenë unë ka pasë, ka pasë nga Vojvodina për shembull, një pianiste që ish shumë e... E kom angazhu unë për, për... po. Mandej ka qenë, ka pasë nga Kroacia gjithashtu, nga Kroacia. Nga Bosnja, gjithka, gjithka. Mirëpo mandej, mandej mas një kohe kanë, prapë kanë lëvizë. Do jonë kthy mbas, do jonë shku, sidomos nga Bosnja jonë shku shumë jashtë, jashtë, pa u kthy mo. Kështu që Bosna ka pësu shumë.

Po kontaktet kanë qenë shumë t’mira se disa nga koleget aty i kom pasë unë gjatë studimeve kemi qenë, po. Ajo që më ka thrritë, na jemi pa në kto, kto, verës që bojshin me pedagogë që vinin nga Rusia, gjithka që vinin. Kom kontakti me të, dhe ajo ka mbjate n’mend, po. Edhe qashtu si e rastit ka qenë, krejtësisht e rastit ajo punë. Edhe kom shku qashtu, po, drejtë e n’mësim. Bile aty, një javë ditë te ajo drejtoresha, burrin e doktoruar, për njëfarë inxhinjeri aty. Shpesh herë i bojke drekat ai, një javë unë aty. Mas një javë u interesu... Jo mos një javë, mas një javë ka siguru, gjatë atyre ditëve u siguru me ma siguru një vend, po, një dhomë dikun. Edhe u gjetë një dhomë e lirë e prindëve të një kolege, shumë ma e re se unë, po. Dhe kom ndejtë, edhe ka thanë për një vjet. Mas një vjeti duhet vetë me e gjetë m’u interesu.

E mandej mas një dy vjete a tri të tjera, ma kanë dhanë në banesë si, domethanë, si, vetëm, pa familje. Edhe e kom hala qata. Domethanë nuk osht’ pronë e imja po në përdorim. Ose duhet me lëshu, ose me mbajtë ose... Jo me shitë (qeshë) e kështu. E tash përndryshe ai aktivitet ka qenë shumë i, shumë intenziv, shumë i... Në kuptimin ma t’mirë t’fjalës. Kom pasë shumë mirëkuptim, po nuk ka pasë në asnjë moment, po, ndonji cakërim, “Pse ky me u ekzekutu? Pse ky ktu?” Për shembull, ndonji, nuk ka pasë hiç fare. Përkundrazi kom qenë aktiv, nuk osht’ kundërshtu ndonji me thonë, “Jo valla këtë here s’muj”. S’ka ndodhë fare, kurrënjihere, po.

Bile kam qenë edhe mentor një kohë i një ma t’rijut kompozitori që erdh, po. Se i kanë ata, i bëjnë mentorët, pavarësisht se a osht’ fakultet, Shkollë e Lartë. Domethanë si konservatim qe osht’ i një niveli Shkollë e Lartë. Ku osht’ shkolla e mesme edhe e ulët, po. Janë ekzekutu vepra, po. Prandaj edhe disa tekste ja siç osht’ ajo kanga, “Mbi ja...” Po, unë qato dy rrjeshta i di në fillim (qeshë). Po, nejsë kisha mujtë edhe ndonji rrjesht tjetër me ditë po ato m’kanë lonë përshtypje. Se edhe titulli osht’, ku jonë ato rrugë, rrugica që ishin dikur, s’jonë tash. Po ishte një, për mu ishte një, një lloj kujtimi domethanë që, qe si erdh puna, po. E kështu me radhë... Edhe ajo, jo do të ketë qenë një shfryrje, një,

nji domethonë, një inspirim, njëri këngëtar popullor, po. Se edhe këngët popullore janë gjithashtu inspirime. Edhe, se edhe ata kanë qenë në vende të tjera, në Austri, në Itali kanë... Dikur ka vjeshta ka pasë ma shumë slloven se sa vetë italian. Edhe tash ka institucione, shkolla po jo si përpara, e kështu.

Mandej në Austri, diçka ka edhe në Hungari. E mandej ka që kanë shku edhe në Amerikë qysh moti, po, qysh në Jugosllavinë e vjetër demok. Po s'kanë qenë bash njësoj republikat kështu. Kështu që, kështu që me, me, me, *pardon* se ndoshta u ndalëm shumë në çështjet tjera. Po intenzivisht unë kom qenë aktiv aty në Maribor, duke qenë Maribor edhe në Slloveni edhe në shoqatë kom lëvizë, kom lëvizë domethanë pa ndonji, domethanë për kerr, domethanë pa ndonji kursim, se nuk ishin, domethanë ishin mundësitë, s'ishte nevoja me kursy. Me lëvizë edhe n'festivale, jo vetëm në... Po në Bled, e në Bohinj, në disa qytete se në kohët e fundit... Se ka shumë festivale, shumë aktivitete në Lublanë, domethanë janë tu u përpjekë që edhe në qendrat e tjera, po... Bukur disa vite, kështu që kam qenë gjithënjë i pranishëm. Edhe kur s'kom pasë ndonji kompozim, po kom qenë, i kom përcjellë.

Ajo, ajo ka qenë gjithashtu një rinfreskim, një intensitet i ngritur n'krahasim me, me, siç ishin kushtet këtu atëhere. Prandaj edhe frymëzimi ka qenë më i madh. Po, sikur edhe frymëzimi, pikërisht ai ma internë që zakonisht thuhet se krijimtaria bohët në vetmi. Domethanë, se ka diçka t'vërtetë aty. Domethanë n'qetësi, n'vetmi, po n'fillim. Edhe në këtë drejtim domethanë ka qenë një aktivitet krijues pa ndërprerje dhe ekzekutimet kanë qenë t'shpeshë, më tepër se sa që mund ti mendoj njëri. Për shembull unë kom ardhë me instrumentist nga Sllovenia disa herë, disa herë.

Kom ardhë gjithsej katër apo pesë herë. Po duke qenë edhe vet aktiv, vet pianist, po. Përndryshe kështu sa për... se e kisha atë mundësinë, s'kisha nevojë me shti edhe një njëri, se po, eh... Domethanë kom ardhë njëherë, kom ardhë për nderë të Nanës Terezë, kur kishe... Në '97-shin, po. Koncert me vepra, me kolegët sllovenë, po. Një herë tjetër kam ardhë dy pianistë, dy pianistë, njëni nga pianistët unë, natyrisht, dhe një kolege e imja nga Lublana, osht' profesoreshë atje. E ka pasë edhe nanën profesoreshë t'pianos, po. Kemi ardhë dy këngëtarë, dy pianist. Maribor mas koncertit. Në Ulqin n'shkollën e mesme t'muzikës, kemi pasë student atë, drejtorin atje. Dhe Prishtinë, Prizren... ka qenë, gjithnjë kanë qenë Prishtinë, Prizren, Gjakovë, po.

Kurse një rast nuk ka qenë në Gjakovë, nuk e di për çka kishte atë ditë që, ato ditë që i kishim t'caktune, me marrëveshje, me organet e komunave, po. Nuk ishte Gjakova, shkumë në Mitrovicë. Në Mitrovicë që domethanë, kjo ishte n'vitet kur nuk ishte bash qetësi atje, po. Mirëpo, ia kalumë shkëlqyeshëm, nuk kishe kurfarë problemi. Osht' një atje që ka qenë drejtor i teatrit komunal të Mitrovicës, një me mjekërr kshu {tregon me duar}, po. Na kanë vendosë në një hotel atje.

**Petrit Çeku:** N'cilin vit përafërsisht?

**Zeqirja Ballata:** Ajo... N'cilin vit? T'shofim çka ishte... Ndoshta, mos osht' në 2004. Po, se qysh, qysh në... Pra i pari ka qenë, apo ndër t'parët në '97-shin. Në të gjitha këto qytete edhe në Prizren, po në Shkollën e Mesme të Muzikës. Natyrisht se këto i bojsha une, mirresha vesh e kështu, po. Po domethanë me instrumentet që i zanin vend në aeorplan, po, natyrisht. Njëherë osht' përkrahë ajo ardhje nga akademia, po, me shumë si ashtu, si anëtar, si moralisht kështu se sa materialisht. Sepse

komuna ka ndihmu. Njiherë nga Ministria e Kulturës të Kosovoës. Njiherë kur kemi ardhë t'katërt... M' duket se edhe atëherë, por njiherë kemi ardhë më shpenzime t'mija, për arsye se, natyrisht, edhe t'gjithë pa honorar, të gjithë kanë ardhë tonë kohën pa honorar (qeshë), kolegët, po. Mirëpo ishin të siguruar domëthanë banimin në hotel, ushqimi, qëndrimi e kështu domëthanë, edhe udhëtimi, po, i siguruar. Këto ishin kryesoret, po.

Kurse njiherë kemi ardhë me kerr, me kerr timin. Domëthanë katër, dy kangëtarë, një basist edhe një soprano nga Lublana, e Akademisë së Lublanës. Soprano e shkëlqyshme, po. Dhe ne të dy, unë me atë pianisten, katër. Dhe jemi ndalë edhe rrugës, e kështu. Eh kështu, po, domëthanë disa, disa që kanë kërku kohë, po ka qenë një, një ambient kështu i kolegëve e kështu. Pa kurfarë dileme pjesëmarrje, edhe lëvizje kështu, edhe kureshtar. Sa herë kemi ardhë i kemi vizitu qytetet. Ai i pari ka qenë kur, kur... nëse ishte '97-ta ma përpara, se kanë qenë... M'fal, ka qenë në '93-shin, i pari, në '93-shin. Se ka qenë dhe një tribunë muzikologjike për veprat edhe kanë qenë të angazhuar, të angazhuar disa vetë. Po, një nga nga Lublana, një nga Tirana, tjerët kanë qenë këtu, prishtinas.

**Petrit Çeku:** Ku u mbjattë?

**Zeqirja Ballata:** U mbjattë në një sallë të hotelit, ajo tribuna muzikologjike. Kurse koncerti u mbjattë në Sallën e Kuqe.

**Petrit Çeku:** Ansambli...

**Zeqirja Ballata:** Po. Kurse ai i pari apo i dyti u mbjattë në sallën e teatrit.

**Petrit Çeku:** Kombëtar?

**Zeqirja Ballata:** Po. Eh kështu.

**Petrit Çeku:** Kështu për fund çfarë i keni aktivitetet sot? A po shkruani shkrime më shumë, apo muzikë? Çfarë?

**Zeqirja Ballata:** Po, po kompozoi gjithnjë kështu diçka. Herë ma ngadalë, herë ma shpejtë domëthanë...

**Petrit Çeku:** Çfarë e keni procesin e komponimit? Me piano shkruani apo...

**Zeqirja Ballata:** Jo. Jo, me piano e provoj n'fund.

**Petrit Çeku:** Ah, në fund.

**Zeqirja Ballata:** Po, po. E provoj, edhe provoj inserte, domëthanë copëza, copëza, po. Përpara, po, moti, moti. Po pastaj ngadalë-ngadalë, ngadalë-ngadalë jom largu, po, sepse e kom bindjën që domëthanë përafësisht i ndigjoj atë që kam shkruar, po.

**Petrit Çeku:** Ndëgjim të brendshëm?

**Zeqirja Ballata:** Po. Mandej kam përvojë nga studimet, nga analizat, partiturat, une kom shumë partitura, domethanë... Pastaj edhe libra mbi orkestracionin, pastaj bëjë gjithënjë ni analizim, analizim mirë e mirë e mirë, e mandej e qes në të pastër kur e shof që ma s... Dhe dorëshkrimet i kam t'gjitha me laps.

**Petrit Çeku:** Me laps?

**Zeqirja Ballata:** Me laps sepse kom pasë fillu edhe me, nesje, lapskimit e kështu, mirëpo mu ka dukë si ma e, ma e randë ajo, po. Sepse duke punuar, ose dilte shkrimi keq ose e ndryshojsha, po, me shly ishte, po... Kështu që gjithënjë kam punu me laps të rëndomtë, edhe tash, edhe tash njisoj.

**Petrit Çeku:** E kom vrejtë te dorëshkrimet tua, se i kom pasë...

**Zeqirja Ballata:** Po...

**Petrit Çeku:** E kom vrejtë që e keni dorëshkrimin jashtëzakonisht të bukur edhe të pastër...

**Zeqirja Ballata:** Po.

**Petrit Çeku:** Osht' shumë bukur. E a mundeni me i tregu një njeriut të ri si une qysh arrihet (qeshë) një dorëshkrim i tillë, faktikisht a keni ushtru me pasë qasi farë...

**Zeqirja Ballata:** Jo, jo... Jo, që kom ushtru po përkujdesja e qitjes në të pastër e ka ba që, domethanë ngadale, edhe me vizore, edhe me vizore, po. E kështu, mandej, mandej osht' edhe ni qështje plus që ka shenja, në të ri domethanë që nodnji që kam bërë edhe unë.

**Petrit Çeku:** Ju i shpikni faktikisht disa...

**Zeqirja Ballata:** Po, eh, eh. Do i kanë shpikë të tjerët, po, do, po... Kom një vend për shembull, nejtse në dy, tre vende jonë kur n'fund kapaku i pianos lëshohet bam [onomatope], po, e lëshohet kapaku.

**Petrit Çeku:** Si i vizatutë atë, si e shënutë?

**Zeqirja Ballata:** Po e kom bo një, një, domethanë një qeshtu që {tregon me duar}, thjeshtë {tregon shigjetë me dorë}...

**Petrit Çeku:** Shigjetë te poshtë.

**Zeqirja Ballata:** Njifarë shigjete, po, po. Edhe natyrisht me fjalë, zakonisht ai...

**Petrit Çeku:** Një...

**Zeqirja Ballata:** Italisht, zakonisht, ose frengjisht, po. Me qenë se i kom pak si ma afër këto gjuhë. Se duhet me ba një gjuhë t'hujë se... Nëse ka raste ekzekutohet dikun tjetër të dij ai, mos të, mos të menon çka duhet me bo tash, njifarë spjegimi. Eh kështu, ka edhe shenja të tjera, po osht' një për shembull, ose ke {godet tavolinën me dorë} me dorë në tela të pianos, po. Ose osht' për shembull e

shtypë telin, tri telëshin, po, ose dy telëshin poshtë ose, eh, po, {tregon me duar} kështu duhet me mbajtë domethanë del një tingull. Një tingull hundak del...

**Petrit Çeku:** Nazal.

**Zeqirja Ballata:** Po, nasal. *Nas* [gjermanisht] osht' hunda (qeshë), po, po. Edhe del një tingull krejtësisht tjetër, një kumbim krejtësisht tjetër, po. Mandej picikato, po, në tel, po. Mandej glisando nëpër, po. Mandej, nejse edhe tek instrumentet e tjera, unë përmenda pianon por edhe tek instrumentet e tjera. Tek trombat, tek trumbeta për shembull, që e kom një që bukur e gjatë osht'. E u ekzekuto ajo, shumë me kërkesa, e kështu.

**Petrit Çeku:** Une e konsideroj që osht' e jashtëzakonshme kjo që me aq entuziazëm iu keni qasë modernizmit europian dhe bashkëkohor...

**Zeqirja Ballata:** Po...

**Petrit Çeku:** E si ka qenë ambienti, si e ka pranë publiku me fjalë tjera muzikën...

**Zeqirja Ballata:** Ku? Ktu?

**Petrit Çeku:** Ktu në Kosovë, po.

**Zeqirja Ballata:** Aha, ktu. Po n'fillim, menjherë si jom kthy, në '71-shin, po, kom qenë mjaft aktiv kështu, si Shkollë e Lartë. Po ne bënim edhe koncerte. Edhe kom marrë, kështu relativisht mjaft herë, edhe si pianist, këtu atëhere, po. Dhe si shembull, ta zomë, Fahriu m'imitonte mu, duke qeshë, se si po i bi une pianos, po (buzëqeshë). Se i kishte për shebull... Po kisha ndonji, ndonji, po, me një ngulmësi, po, që nuk osht' zbulimi imi. Po kom pa pianistë bashkëkohor që domethanë nuk bënë thjeshtë kështu {bënë sikur i bjen pianos} po bon edhe një lëvizje, njëfarë afrimi gati, po. Ajo osht' diçka shumë spontane, domethanë s'e kom bo në mënyre artificiale. Ose edhe ndonji, po, ndonji pedal kështu, qoftë, po, ta quaj kështu, të tmerrshëm, po... Dhe me ndërprerje të shpejtë, po, pra se për me ndërpre kështu, do të bësh prapë një gjest, po. Herë e lëshon pedalen ose jo, domethanë edhe duken ato, nga jashtë, nga një njeri që domethanë nuk osht' i lidhur me... Po, ose s'ka pasë rast, ose kështu, i duket pak qesharake. Natyrisht ata që janë të tjerët, të tjerët me siguri edhe më tepër, po.

E kështu... E këtë e kom hetu që edhe në ndonji koncert atje, ose ku kam marrë pjesë si pianist, po. Ata edhe m'kanë, po, edhe kom fotografi por që i kanë bo të tjerët (qeshë) edhe mandej m'i kanë dhonë, m'i kanë dhonë kështu. Domethanë, kështu që disa, domethanë gjeste për dikënd osht' dukë ajo si e jashtëzakonshme, pak si qesharake. Se Fahriu osht' edhe përndryshe kështu...

**Petrit Çeku:** (Qeshë) Po.

**Zeqirja Ballata:** Po. E kështu. Për shembull në Itali, se harrova me përmend. Mandej kom qenë mas dy here kom qenë edhe në Romë pastaj te ai, ka qenë Goffredo Petrassi. Kom qenë prej 1 tetorit deri, te ai, po, deri në maj. Natyrisht me të gjitha pushimet e kështu si ndërmjet, e kështu. Udhëtojsha me tren,



udhëtojsha me tren, po. Rrisha dy-tri ditë, kthehesha mas një jave. E ka pasë raste kur nuk ishte, më lajmëronte që këtë javë mos eja, e kështu domethanë. Ai ka qenë atëherë... kjo ka qenë '71, '72, ah po, se intenzivisht në kom shku, po. '68, '69, jo, '69, '70... '69-shin edhe '70-shin. Mandej kam qenë në '71, apo '70, '71... '71, '72, kështu ka qenë. Po se në... Po te njëni osht' vazhdu menjherë, si u kry njëni, u vazhdu tek tjetri, e kjo ka qenë, po... kjo ka qenë verës '72, '73... S'po di tash qysh i ka ra kjo...

**Petrit Çeku:** S'osht' me randsi.

**Zeqirja Ballata:** Po. Po, dy here nga... qajo. Përafërsisht osht' njëfarë lloj tre-mujshi. Nuk osht' intensiv ai tre-mujsh, domethanë po osht' qashtu, njëfarë vere. Quhen ato ashtu. *Corso, corso per stranieri, Di specializzazione per stranieri* [Kursi i specializimit për te huajt], për te huajt, po. Sidomos në, në, tek Franco Donatoni, aty ka qenë shumë intensive, po...

**Petrit Çeku:** Faktikisht...

**Zeqirja Ballata:** Tani ktu, ktu tash, tani ktu në Kosovë natyrisht se ka edhe anagime të tjera domethanë, kështu që kjo rezultati se intensiteti osht' pak ma, ma i vogël, ma i ulët osht', po. Natyrisht osht' edhe mosha, po. Pastaj jo angazhime të tjera, jo ktu, jo shoqata, jo...

**Petrit Çeku:** Si e shihni t'ëndësishme një shoqatë siç është Shoqata e Kompozitorëve që të ringjallet tash në Kosovë? Ju keni marrë përpjeke për me...

**Zeqirja Ballata:** Po, dhe...

**Petrit Çeku:** Faktikisht e keni kriju...

**Zeqirja Ballata:** Po. Osht', osht' rinovu. Po, osht' ripërtëri si t'them....

**Petrit Çeku:** A i keni ende ambientet e Shoqatës që kanë qenë përpara?

**Zeqirja Ballata:** Jonë, jonë ambientet po jonë ambiente të dëmduara. Të dëmtuara dhe jemi duke u përpjekur kto, ja kto, gati pesë vjet po bohen se duhet të bëjmë edhe rizgjedhjen. M'duket... kjo osht' që një vit, po, idea. Duke pritur mos po marrim ndonji përkrahje, sidomos nga komuna ose nga Ministria e Kulturës e Kosovës. Deri më tash nuk kanë shprehë ndonji përkrahje konkrete për ndonjë rinovim, për ndonjë përkrahje materiale për të u mbajtur. Në mënyrë që dimër e verë me shku, me i pasë kushtet aty, çfare i ka një lokal ku do të rrijnë 10, 15, 20, 30 njerëz, po.

Por ka një, një shpresë që komuna... bile, bile kom qenë une para një muji përafërsisht me u taku sepse e patëm lanë dhe, që të shifem me kryetarin e komunës. Dhe kemi lanë që domethanë këto ditë të shifemi. Po, kur isha njëherë dhe m'u tha që, nuk ishte janar por ishte... m'duket dhjetor që une kërkova qatëhere mu pa sa isha aty. Po u tha, që domethanë, "Ka ngarkesa dhe do të shifemi nga fundi i janarit". Qekjo osht' dhe po shpresojmë mos po bahet diçka, po. Qoftë duke e rinovu, qoftë duke e ba krejtësisht siç ka mundësi m'u ba ajo. Ajo ka mundësi edhe vetë m'u bo, se osht' pronë e Shoqatës. Po ne duam, dhe unë pra gjithashtu, jo me i dhanë dikujt e me bo e mandej, "Qysh u dha? Si u dha? Pse u

bo kaq? Pse osht' edhe dikush tjetër ni kat ma nalt?" A ku e di unë, po. Po me marrë ni institucion shtetëror, qoftë Ministria e Kulturës të Kosovës, qoftë komuna.

Ose, nëse jo, me përkrahë këtë ide po ajo me marrë përsipër që mos me pasë, domethanë me u bo zyrtarisht ajo. Mos me u bo, "Jo ky kryetar, jo ai kryetar, jo s'kemi qenë të gjithë, jo pse u bo kshtu..." Ku e din unë, po domethanë kjo osht' dëshira që mos me ngelë ndonji, mos me u bo ndonji gabim që mund te nxjerrin telashë antarëve, përfoljeve të ndryshme. Dhe kjo osht' praktikisht, po. Të shofim, të shofim sepse ka oferta, ka oferta të ndonji institucioni të vogël që a bohen me na lshu neve, punojmë s'bashku, e ne mund të ndihmojmë se ne i kemi kushtet, po. Mirëpo edhe ktu une e kom njifarë, njifarë rezerve që po shtyhet kjo punë, që osht' kjo gjendje.

Ah përndryshe desha të them, nuk e përmenda, domethanë sa i përket Shoqatës dhe anëtarëve, domethanë ka një, ka një prurje që themi na, apo jo... në këto kohët e fundit domethanë, se po dalin pedagog të ri, kompozitorë të ri, instrumentistë të ri. Se këto jonë krejt rreth, këto jonë edhe n'shërbim të kompozitorëve. Instrumentisti me kompozitorin osht' i lidhur si mishi me thonin, apo jo? Siç thuhet... Po edhe pedagogët, gjithashtu. Dhe mbrenda pedagogëve, pedagogët e landëve studiuase dhe pra studimore, siç osht' muzikologjia, po, kritika profesionale, pra, po. Natyrisht osht' duke shkuar shumë ngadale por ka shenja në këto dhjetë vjet e fundit. Pastaj ka një dëshirë dhe një sukses n'këtë drejtim edhe me çështjen e shkollimit. Pra magjistraturës, doktoraturës, po.

Pavarësisht që osht' një element tjetër që domethanë, pakëz niveli, tek ne në këtë drejtim osht' pak si i luhatur, si po magjistrojnë e po doktorojnë, po. Por, megjithatë nga, nga kandidatë të caktuar ka një dëshirë për t'u avansuar në ngritje sa më të larta ose ka madje të tillë. Ndoshta nuk kemi bash n'laminë e muzikës por në disa degë shkencore ku studenti i kryenë studimet edhe para kohe. Para kohe magjistrin, para kohe doktoron. Po, disa të ri dhe prandaj ne në Akademinë e Shkencave ktu kemi, kemi një shpërblim, po, për raste të tilla që, që, po... Tregojnë një talent të veçantë, po.

Kështu që, kemi shpresë që domethanë, mos t'flas për instrumentistë, po. Se nuk u ndala, nuk u ndala te instrumentistët. Deshta të them që tek instrumentistët osht' rasti duke shkuar shkëlqyeshëm sepse, qofshin instrumentistë, qofshin, domethanë kangëtarë... Hapa, hapa shumë t'guximshëm dhe suksese. Pikërisht për shkak të guximit, se marrin guxim t'ritë, sapo të diplomuar, apo gjatë studimeve, apo mënjherë pas studimeve... Jo vetëm thjeshtë për t'shkuar për t'studiuar po marrin pjesë edhe në gara të ndryshme në këre drejtim. Domethanë kemi arritje tek instrumentistët tanë. Domethanë që kalojnë, kalojnë përmasat jo vetëm thjeshtë kombëtare të ngushta, por edhe ndërkombëtare, në kuptim e gjërë të fjalës. Edhe që osht' një kënaqësi e posaçme për, për gjithë ne. Po posaçërisht për ne krijuesit, po, dhe t'gjithë muziktarët n'përgjithësi.

**Petrit Çeku:** Po m'pëlqen qekjo me përfundu kshtu në...

**Zeqirja Ballata:** Po, gjithsesi. Njihërit, me këtë rast unë ju falendërohem për këtë ide dhe m'vjen mirë që e kisha rastin që të, që të bisedojmë dy, domethanë dy intelektual dhe dy muziktar, a po...

**Petrit Çeku:** Shumë faleminderit, profesor. Kjo ishte shumë e vleshme për mu, faleminderit.